



QENDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TE FEMIJEVE NE SHQIPERI

Children's Human Rights Centre of Albania - CRCA

ABUZIMI I FEMIJEVE NE FAMILJE



Pergatitur nga:

Prof. Asoc. Dr. Edlira Haxhiymeri
Eliona Kulluri
Altin Hazizaj

Redaktuar nga:

AURELA PANO

Gusht 2005, Tirane

FALENDERIME

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri – CRCA dhe Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri – IRCCRA, dëshirojnë të falenderojë për përgatitjen e këtij studim - raporti në mënyrë të veçantë:

- Znj. Edlira Haxhiymeri, znj. Eliona Kulluri dhe z. Altin Hazizaj për mbledhjen në kohë dhe analizimin e fakteve, dokumentave, të dhënave dhe intervistave, si dhe për përgatitjen e këtij Raporti.
- Znj. Aurela Pano, për rishikimin dhe redaktimin e vazhdueshëm të këtij Raporti.
- Olof Palme International Center, Suedi, për mbështetjen financiare të programit ‘Të Drejtat e Fëmijës janë të Drejta Demokratike’, si dhe për mbështetjen financiare në përgatitjen dhe botimin e këtij Raporti.
- Të gjithë femijët, të cilët folën hapur me ne rreth jetës, problemeve, frikës, dhe shqetësimeve të tyre.
- Strehëzen për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, Tiranë, për venien në dispozicion të informacionit dhe të dhënave që janë përfshirë në këtë Raport.

PERMBAJTJA

	Faqe
1. PERMBLEDHJE E PERGJITHSHME	4
2. HYRJE	5
- Abuzimi i femijëve në familje	5
- Metodologjia e studimit	5
3. KONCEPTI I ABUZIMIT TE FEMIJES	6
- Definicioni i Abuzimit të Femijës	6
- Format e abuzimit	6
- Abuzimi fizik	7
- Sindroma e bebes së shkundur	7
- Abuzimi emocional	8
- Abuzimi seksual	8
- Neglizhenca ndaj femijës	9
4. ABUZIMI I FEMIJEVE DHE KONTEKSTI LIGJOR	10
- Definicioni i femijës së abuzuar dhe neglizhuar	10
- Legjislacioni shqiptar dhe abuzimi i femijës	10
- Kodi i Familjes dhe koncepti i ‘përgjegjësisë prindërore’	11
- Politikat qeveritare dhe abuzimi i femijës	12
5. MBROJTJA E FEMIJEVE NGA ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA	13
- Skema e mbrojtjes, përkujdesjes, referimit dhe institucionet përgjegjëse	13
6. QENDRIMI SOCIAL NDAJ ABUZIMIT TE FEMIJES	15
- Shkalla e pranueshmërisë nga shoqëria e abuzimit të femijëve në familje	15
- Prindërit dhe pritshmëritë e tyre nga fëmijët	15
- Shkalla e pranueshmërisë së abuzimit nga fëmijët	16
- Këndvështrimi i profesionistëve për fenomenin	16
7. SHKALLA E PERHAPJES SE ABUZIMIT TE FEMIJES	17
- Përmasat e fenomenit	17
- Profili i familjeve abuzuese	18
8. PROFILI I FEMIJEVE DHE PASOJAT E ABUZIMIT	20
- Profili i femijës së abuzuar	20
- Pasojat e abuzimit tek fëmijët	20
9. RASTE STUDIMORE	22
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	26
- Konkluzione	26
- Rekomandime	27
11. LITERATURA DHE KONTAKTE	30

1. PERMBLEDHJE E PERGJITHSHME

Abuzimi i fëmijëve në Shqipëri nuk është një fenomen që po përjetohet vetëm vitet e fundit. Për vite me radhë askush nuk ka guxuar të ngrere shqetesimin për çeshtjen e fëmijëve të abuzuar dhe pasojat e abuzimit tek femija.

Studimi kualitativ që po ju paraqesim mbi abuzimin e fëmijëve në familje, është rezultat i një punë të gjatë kërkimore dhe praktike për të identifikuar problemin, njohur shkaqet, për t'u përballur me realitetin duke ju ardhur në ndihmë viktimave të abuzimit, prindërve abuzues dhe të gjithë atyre institucioneve, organizatave dhe individëve që janë të interesuar të parandalojnë ose kurojnë fenomenin e dhimbshëm të abuzimit të fëmijëve.

Studimi është mbështetur në literaturën bashkëkohore mbi këtë fenomen, në studimet e individëve dhe grupeve që veprojnë në Shqipëri në këtë fushë. Në mënyrë specifike studimi mbështetet në rastet e fëmijëve të dhunuar që janë trajtuar në Strehëzën për gratë dhe vajzat e dhunuara në Tiranë, si dhe ato të trajtuara pranë CRCA.

Dhuna ndaj fëmijëve shfaqet në forma të ndryshme si dhunë fizike, emocionale, neglizhim dhe dhunë seksuale. Studimi mundohet të japë një përkufizim të dhunës në përgjithësi ndaj fëmijëve si “çdo sjellje apo qëndrim që dëmton ose rrezikon mirëqënien emocionale, fizike të fëmijës si dhe shkakton ndërprerje të procesit normal të zhvillimit”.

Në studim zënë vend qëndrimet mbi abuzimin duke u ndalur tek shkalla e pranueshmërisë së fenomenit nga ana e shoqërisë, qëndrimet e prindërve ndaj dhunës, shkalla e pranueshmërisë së dhunës nga vetë fëmijët dhe qëndrimi i specialistëve për këtë problem. Ende në shoqëri shqiptare predominon mendimi se “druri ka dalë nga xehneti”, dhe kjo e bën të vështirë luftën ndaj fenomenit.

Fenomeni i dhunës kërcënon të gjithë fëmijët pavarësisht moshës, vendbanimit, gjinisë dhe nivelit social ekonomik të familjes. Për të ilustruar këtë argument në studim janë paraqitur të dhëna për familjet e fëmijëve të abuzuar.

Abuzimi krijon pasojat fizike dhe emocionale, ndonjëherë edhe të pariparueshme, tek fëmijët. Keto

pasojat do të ndjekin fëmijën në çdo hap të jetës së tij, edhe si të rritur, nëse ato nuk trajtohen dhe nuk iu jepet ndihma e duhur, ato mbartin rrezikun e krijimit të prindërve të dhunshëm në të ardhmen.

Dhuna shkakton dëmtime emocionale, mendore, të personalitetit, duke bërë që fëmijët e dhunuar të fitojnë karakteristika të tjera nga ato të bashkëmoshatarëve të tyre. Kështu, ata nuk kërkojnë ndihmë, nuk dinë të ankohen, mbyllën në vetvete, rriten para kohe, nuk kanë besim tek njerëzit që i rrethojnë, kanë çrregullime të të ngrënit, kanë probleme me urinimin dhe përgjithësisht kanë çrregullime të të mësuarit dhe jo ralle karakterizohen nga një fjalor i varfër dhe vulgar. Për të ilustruar këto karakteristika specifike të fëmijëve, në këtë studim është përfshirë një kapitull i veçantë, i quajtur “Zëri i fëmijëve”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal, Kodi Civil dhe Kodi i ri i Familjes ju garantojnë fëmijëve mbrojtje të të drejtave themelore, por mbetet ende për të bërë në funksion të perfeksionimit të kuadrit ligjor, si dhe të zbatimit të tij nga institucionet perkujdesese.

Si konkluzion, mund të themi se abuzimi i fëmijëve nuk njihet kufinj, por fëmijët që referohen për ndihmë janë kryesisht nga shtresat e varfëra dhe më të rrezikuara të shoqërisë. Gjatë viteve të fundit janë shënuar rritje të rasteve të dhunës ekstreme ndaj fëmijëve në familje. Abuzimi ndaj fëmijëve bëhet nga persona brenda familjes ose të afërt me to, ndonëse nuk mungojnë rastet e abuzimit nga të panjohurit. Rrënjët e këtij fenomeni qëndrojnë në mentalitetin patriarkal që karakterizon familjen dhe gjithë shoqërinë shqiptare.

Ndonëse ka një nivel ndërgjegjësimi të popullsisë për abuzimin e fëmijëve, ende mbetet shumë për të bërë në mënyrë që të kapërcehen stereotipe dhe modele të dhunshme të prindërimit. Për të arritur këtë objektivi kërkohet një bashkëpunim më i mirë i shoqërosë civile, strukturave të shtetit, prindërve dhe specialistëve të fushës.

1. HYRJE

1.1 Abuzimi i femijeve ne familje

Abuzimi i fëmijëve ne familje nuk është një fenomen i ri për shoqërinë moderne. Ai është ndeshur që në fillimet e shoqërisë njerëzore. Kështu, Ligji Romak i jepte babait të drejtë absolute mbi fëmijën. Kjo e drejtë kuptohej si një e drejtë për të vepruar mbi fëmijën me çdo mjet. Në Mesjetë fëmijët me prapambetje mendore digjeshin në turrën e druve.

Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore kanë ndryshuar dhe evoluar edhe sjelljet e qëndrimet ndaj fëmijëve. Prindërit në të shumtën e rasteve, ju kanë ofruar kujdes fëmijëve të tyre dhe kanë siguruar kështu mbijetesën e qenieve njerëzore. Pavarësisht nga diferencat kulturore, fetare apo morale rreth mënyrës së edukimit dhe rritjes së fëmijës, abuzimi i tyre asnjëherë nuk është pranuar nga shumica e shoqërisë. Familja është konsideruar gjithmonë si institucioni që është përgjegjës për rritjen e fëmijës dhe jo për abuzimin e tij. Shtete të ndryshme kanë përjetuar periudha eksperiencash të ndryshme lidhur me qëndrimet ndaj abuzimit të fëmijëve.

Gjatë shekullit të kaluar qëndrimi ndaj problemeve të abuzimit të fëmijëve mori një kthesë të plotë. Mendimi psikologjik, që gjatë kësaj periudhe shënoi një zhvillim të jashtëzakonshëm, theksoi për herë të parë rëndësinë kritike të moshës së fëmijërisë në zhvillimin e personalitetit dhe të karakterit të individit. Psikologët që në atë kohë dhe vazhdimisht po vënë theksin në përdorimin e metodave sa më njerëzore në edukimin e fëmijëve. Megjithëse shumë vende të botës e kanë të ndaluar me ligj abuzimin e fëmijës, ai ende vazhdon të përdoret nga prindërit për qëllime disiplinimi. Ndërkohë autorë të ndryshëm vazhdojnë të debatojnë rreth problemit të përkufizimit të asaj se çfarë mund të konsiderohet abuzim i fëmijëve dhe çfarë konsiderohet disiplinim, dhe a mund të vendoset një kufi ndarës midis këtyre dy lloj qëndrimeve.

Edhe në vendin tonë qëndrimet lidhur me këtë problem kanë ndryshuar në vite. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar por, edhe në fillimet e shekullit të ri, probleme të tilla si abuzimi i fëmijëve, abuzimi i grave, trafikimi i qenieve njerëzore për qëllime përfitimi, prostitucioni, e të tjera si këto janë bërë pjesë e diskutimeve, debateve, shkrimeve dhe publikimeve, kërkimeve, politikave dhe shërbimeve në funksion të grupeve të rrezikuara.

Trajtimi i problemit të abuzimit të fëmijëve në Shqipëri si një problem social ka një histori jo shumë të gjatë. Ky problem filloi të diskutohej në fillim të viteve '90, atëherë kur lëvizja qytetare nisi të merrte jetë si rezultat i ndryshimeve politike që po ndodhnin në vend. Interesi i publikut, i strukturave shtetërore dhe i specialistëve u rrit ndjeshëm falë punës së shumë OJF-ve, të cilat jo vetëm organizuan fushata sensibilizimi në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, viktima të dhunës, por dhe ofruan të parat shërbime psiko-sociale dhe mbështetje ligjore.

Nga pikëpamja sociologjike legjitimiteti i një problemi social kërkon domosdoshmërisht studimin e shkallës dhe përmasave të kërcënimit që ky problem i bën shoqërisë. Probleme si abuzimi i fëmijëve, i cili përfshin shumë aspekte dhe që në shumicën e rasteve mbahet i fshehur, janë probleme të vështira për t'u diagnostikuar në mënyrë që të posedojmë një pamje reale të realitetit social. Fakti që ky problem as që është diskutuar më parë, por edhe është mbajtur i mbyllur, i heshtur, e bën edhe më të vështirë studimin e tij.

Duke qenë se interesi për problemin e abuzimit të fëmijëve ka qenë në nivele të ulta, sot ose nuk gjenden ose ka fare pak të dhëna dhe shifra statistikore për të ilustruar përmasat e problemit. Studimi më i mundshëm është ai që mund të bëhet mbi bazën e rasteve të trajtuara në shërbimet e ngritura për t'ju ardhur në ndihmë kësaj kategorie fëmijësh, ose dhe mbi bazën e opinionëve të testuara mbi bazë pyetësorësh.

Vitet e fundit situata e abuzimit të fëmijëve duket se ka ndryshuar. Gjithnjë e më shumë organizata dhe institucione të ndryshme kanë iniciuar aktivitete që synojnë uljen e frekuencës së dhunës ndaj fëmijëve. Problemi i abuzimit të fëmijëve po diskutohet gjithnjë e më shpesh në media duke ndihmuar edhe në shtimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët. Megjithëse ende nuk ka një sistem të specializuar për të ndihmuar fëmijët, dhe se ndryshimet në legjislacion janë bërë të domosdoshme për t'u realizuar në mënyrë që të zbatohen standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, fakti që shteti nuk ka më monopolin mbi problemet sociale, ka dhënë efektet e veta edhe në këtë aspekt të jetës së individit.

1.2 Metodologjia e studimit

Studimi mbi abuzimin e fëmijëve në Shqipëri është mbështetur në përpunimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar të trajtuar në Strehëzën për Gratë dhe Vajzat e

Dhunuara në Tiranë. Këto raste janë grumbulluar me një shtrirje kohore nga viti 1998 deri në fund të vitit 2003. Kjo është edhe periudha e funksionimit të Strehëzës si një shërbim i specializuar për kategorinë e grave dhe vajzave të dhunuara, të cilat në shumicën e rasteve kur referohen për të marrë ndihmë, sjellin me vete edhe fëmijët e tyre që janë jo më pak të dhunuar e të traumatizuar se nënat e tyre.

Çdo fëmijë i trajtuar gjatë kësaj periudhe rezultoi i regjistruar në një dokument më vete ku figurojnë të dhëna të plota të përgjithshme për moshën, rrethin nga vjen, të dhëna për familjen, problemet që shfaq, dhe mënyrën e ndërhyrjes.

Si metodë për mbledhjen e të këtyre të dhënave të rregjistruara përgjithësisht janë përdorur intervistat të strukturuar, por në të njëjtën kohë janë realizuar edhe intervista të passtrukturuar me fëmijët dhe nënat me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore dhe historive për secilin rast.

Bisedat kokë më kokë me fëmijët, interpretimet e punimeve të tyre, komentet mbi përrallat apo diskutime për filma dhe libra të ndryshëm, janë vetëm disa nga mënyrat që janë përdorur për të komunikuar me fëmijët dhe për të mësuar për problemet që ato përjetojnë dhe shkallën e dëmtimit të zhvillimit të tyre.

Studimi sjell një këndvështrim bëshkëkohor të fenomenit të abuzimit të fëmijëve në familje në Shqipëri. Në studim reflektohen edhe studime të tjera të organizatave dhe individëve që shërbejnë në këtë fushë.

3. KONCEPTI I ABUZIMIT TE FEMIJES

3.1 Definicioni i Abuzimit te Femijes

Autoret e këtij studimi duke ju referuar shumë botimeve në këtë fushë, por mbështetur edhe në eksperiencën e tyre të punës më rastet e fëmijëve të abuzuar do ta përkufizonin dhunën ndaj fëmijëve si:

Abuzim i femijes do te konsiderohet çdo lloj forme e keqtrajtimit ose neglizhences qe shkakton si pasoje demtimin ose plagosjen e femijes, e cila nuk mund te shpjegohet ne menyre te arsyeshme. Abuzimi i femijes perfshin: abuzimin fizik, emocional dhe seksual, si dhe neglizhencen.

Në legjislacionin shqiptar mungon një definicion i qarte për fenomenin e abuzimit të femijës. Si Kodi Penal ashtu edhe Kodi i Familjes nuk japin një përcaktim se cili veprim ose mos-veprim i prinderve të femijës do të konsiderohet nga ligji si abuzim i femijës. Meqë për një kohë të gjatë legjislacioni shqiptar e ka konsideruar femijën si objekt dhe jo si subjekt të ligjit, është e lehtë të kuptohet pse mungon definicioni. Si rrjedhojë, mungesa e definicionit e e bën të vështirë dhe ndonjëherë të pamundur mbrojtjen e femijeve të abuzuar përpara gjykatës ose institucioneve administrative.

Megjithatë Konventa për të Drejtat e Femijës e OKB-së, përcakton një sërë masash që shtetet palë, duhet të marrin për mbrojtjen e femijëve nga abuzimi në familje dhe shoqëri.

3.2 Format e abuzimit të fëmijëve

Neni 39, Konventa për të Drejtat e Femijës e OKB-së

Shtetet palë marrin të masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik dhe psikologjik dhe ri-integrimin në shoqëri të çdo femije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor e poshtëruës ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ri-integrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Dhuna ndaj fëmijëve shfaqet dhe realizohet në disa forma: emocionale, fizike, seksuale dhe në formën e neglizhencës. Në praktikën e trajtimit të fëmijëve të dhunuar vihet re se nuk ka raste të pastra të një forme të dhunës. Dhuna tek fëmijët takohet në forma ku ndërthuren të gjitha ose disa nga format së bashku. Përkufizimet e mëposhtme ju referohen formave kryesore të abuzimit dhe kjo është bërë me qëllim që lexuesit të kuptojnë më mirë shkaqet që çojnë në forma të ndryshme të dhunës ashtu sikurse edhe karakteristikat specifike që fitojnë fëmijët që përjetojnë një ose disa nga këto forma.

a) Abuzimi Fizik

Abuzim fizik do të konsiderohet çdo veprim, i cili rezulton në traumë jo-aksidentale, dëmtim ose plagosje të fëmijës. Dhuna fizike përfaqëson dhunim trupor të pa-arsyetuar ose një dënim të pajustificuar. Kjo ndodh zakonisht kur një prind ose kujdestar i nervozuar ose frustruar godet, shkund ose hedh tutje fëmijën. Dëmtimet nga abuzimi fizik vijnë si pasojë e goditjes me grushta, shkelma, rrahjes, djegies dhe çdo veprim tjetër që shkakton dëmtim tek fëmija. Ndonëse këto dëmtime mund të ndodhin tek femija aksidentalisht kur ai / ajo luan, abuzimi fizik duhet të dyshohet se ndodh në rastet kur dëmtimi ose plagosja e fëmijës nuk mund të justifikohet thjesht nga loja, ose nga shpeshësia e ndodhjes së tyre. Sa më shumë të zgjasë abuzimi, aq më serioze do të bëhen dëmtimet tek fëmija, dhe akoma më e vështirë bëhet eliminimi i sjelljes abuzive.

Goditja me shuplakë shpesh konsiderohet si një veprim që i shërben disiplinimit të fëmijës, por që në fakt është një formë e abuzimit të fëmijës, pavërsisht nëse lë shenja apo jo. Përdorimi i forcës fizike si dënim shkërmoq nevojat e fëmijëve për dashuri dhe e dëmton gjithë botën e fëmijës.

Abuzimi fizik konfirmon edhe një herë dobësinë e moshës fëmijnore, frikën e fëmijës për mbrojtjen e tij dhe realitetin e pavarësisë së tij. Në shumë raste prindërit pasi i bërtasin fëmijës, nuk mundet t'i kontrollojnë më emocionet e tyre, dhe në vend që të mundohen të kuptojnë fëmijën dhe t'i shpjegojnë sjelljet e tyre, përdorin forcën fizike. Kete sjellje shpesh e justifikojnë me vendosjen e disiplinës prindërore. Abuzimi prek çdo lloj moshe tek femija nga lindja e tij deri në moshën 18 vjeç.

Kështu B. 10 vjeç, nga Tirana është flakur nga kati i dytë i ndërtesës, ku ai banonte, nga i ati i cili e kryen këtë akt pasi kishte konsumuar alkool. "Zoti më shpëtoi djalin"-shprehet e ëma.

Ndërsa M. nuk do ta harrojë kurrë atë natë kur u ngjit me vrap shkallëve të pallatit për të mbërritur sa më shpejt në shtëpi, ku e priste një shuplakë e fortë nga i ati, aq sa i doli gjak nga hundët.

b) Sindroma e Bebes se shkundur (Shaken Baby syndrome)

Sindroma e bebes së tundur

Një nga format e abuzimit fizik që njihet pak në Shqipëri është sindroma e tundjes së fëmijës, i cili për pasojë mund të shkaktojë vdekjen ose paaftësi të përhershme tek fëmijët e poraslindur.

E qara është gjuha universale e fëmijëve të vegjël, është mënyra se si ata komunikojnë me të tjerët për nevojat e tyre. Për disa prindër apo kujdestare e qara bëhet e besdisshme. Në keto raste, kur fëmija qan shumë, prindërit nuk dinë si ta qetesojnë dhe përveç se bërtasin e tundin beben që ta trembin, në mënyrë që ta bëjnë të pushojë. Por muskujt e qafës së fëmijës janë të paaftë për të përballuar tundjen që u bëhet dhe kjo shpesh mund të shkaktojë hemorragji në tru, që mund t'i marrë edhe jetën fëmijës.

Fati i fëmijës për të shpëtuar varet nga moshja e tij dhe nga shpeshësia e kësaj ndodhie. Ndonëse femija mund t'i shpëtojë vdekjes, pasojat e vonshme të sindromit të bebes se tundur janë të rrezikshme.

Shpesh femija me sindromën e "bebes së tundur" në vitet e ardhshme shfaq probleme me të mësuarin, prapambetje të zhvillimit, probleme në artikulimin e fjalëve, epilepsi, humbje të dëgjimit, verbim parcial ose total, dëmtime të shtyllës kurrizore, paraliza dhe prapambetje mendore.

c) Abuzimi emocional

Abuzim emocional do të konsiderohet çdo veprim i prindit ose kujdestarit që konsiston në përcëimin sistematik të fëmijës dhe që demton në mënyrë serioze zhvillimin e tij. Abuzimi emocional (psikologjik) është një nga format më pak të studiuar në Shqipëri të abuzimit të fëmijës, ndonëse është një nga format më të rënda dhe më destruktive të të gjitha llojeve të abuzimit.

Meqenëse abuzimi emocional godet psikikën e fëmijës dhe konceptin e fëmijës për vetveten, ku viktimat e shohet veten si të pavlerë për dashuri dhe afekcion nga familja. Fëmijët që në mënyrë të vazhdueshme ndjehen të turpëruar, të poshtëruar, të terrorizuar ose të papranuar nga familja, vuajnë po aq, ose edhe më tepër, sesa ç'mund të vuanin nga abuzimi fizik.

Një fëmijë që privohet nga ushqimi emocional baze që në fëmijëri, ndonëse nga ana fizike mund të jetë i shëndetshëm dhe familja kujdeset për të, ka shumë mundësi që të mos përparojë asnjëherë në jetë dhe sigurisht kjo mund t'i shkaktojë edhe vdekjen. Deprivimi emocional i fëmijëve që në moshë të vogël mund të bëjë që fëmijët kur rriten të jenë të anktshëm dhe të pasigurtë, që kanë vështirësi në zhvillimin e tyre ose që nuk kanë vlerësim për vetveten.

Llojet e abuzimit emocional

Refuzimi – Prindërit që nuk kanë aftësinë që të lidhen me fëmijën, shpesh shfaqin sjellje refuzuese ndaj tij. Ata mund t'i thonë fëmijës në mënyrë të ndryshme si ai / ajo janë fëmijë të padëshiruar. Ata mund t'i kërkojnë fëmijës që të largohet, mund t'i vendosin atij / asaj emra fyes, ose i thonë fëmijës se është i pavlerë. Prindërit mund të refuzojnë të flasim me fëmijën, dhe fëmija mund të quhet fajtor për të gjitha problemet që ka familja.

Injorimi – Të rriturit që kanë patur probleme me plotësimin e nevojave të tyre emocionale, shpesh janë të paafte t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve të tyre. Ata mund të mos tregojnë lidhje emocionale (attachment) me fëmijën e tyre, duke treguar ndaj tyre asnjë kujdes emocional. Ata (prindërit) mund të mos tregojnë asnjë interes ndaj fëmijës, shenjë afekcioni ose të njohin

prezencën e fëmijës. Në shumë raste prindi është fizikisht aty, por emocionalisht ai / ajo mungon.

Terrorizimi – Prindërit mund ta vendosin fëmijën përpara kritikës ose dënimit. Ata mund ta përqeshin atë kur fëmija shfaq emocione normale për një fenomen të caktuar, ose presin nga fëmija diçka që është jashtë mundësive normale të fëmijës. Fëmija shpesh kërcënohet nga prindërit me vdekje, vrasje, prerje ose braktisje.

Izolimi – Një prind që abuzon me fëmijën nëpërmjet izolimit të tij, mund të mos e lejojë fëmijën që të përfshihet në aktivitete të moshës me fëmijët e tjerë, mund ta mbyllë fëmijën në dhomën e tij / saj, duke mos e stimuluar ekspozimin e tij / saj në shoqëri; ose e ndalon fëmijën adoleshent për të marrë pjesë në aktivitete jashtë-shkollore. Prindërit mund të kërkojnë që fëmija të qëndrojë në dhomën e tij / saj që nga momenti kur kthehet nga shkolla deri në mëngjesin e ditës tjetër, ose i kufizon fëmijës të ngrënë, duke e izoluar ose përjashtuar atë nga mjedisi në shtëpi.

Korruptimi – Prindërit mund të lejojnë fëmijën që të përdorë drogën ose alkoolin, të keqtrajtojë kafshët, të shikojë materiale pornografike ose akte seksuale ndërmjet të rriturve; të vëzhgojë ose të marrë pjesë në aktivitete kriminale si: vjedhja, dhuna ndaj të tjerëve, prostituimin, lojra fati etj.

c) Abuzimi seksual

Abuzim seksual do të konsiderohet çdo lloj përdorimi i fëmijës për qëllime ose kënaqësi seksuale. Abuzimi seksual ndikon negativisht në zhvillimin normal dhe shëndetësor të fëmijës, si në drejtimin emocional ashtu edhe atë fizik. Shpesh fëmijët viktimat të abuzimit seksual vuajnë shqetësime të rënda emocionale nga ndjenja e tyre e turpër, fajit, ose ndjenja të tjera të cilat shoqëria i imponon atyre.

Në ekstremën e abuzimit seksual, përfshihet edhe marrëdhënia seksuale me fëmijën si dhe derivatet e saj. Këto sjellje mund të jenë veprimet finale në një abuzim që ka nisur më parë. Për këtë arsye dhe për shkak të efekteve shkatërruese, ekzibicionizmi (tregimi i organeve seksuale), prekja dhe çdo kontakt tjetër seksual me fëmijën, do të konsiderohen abuzim seksual.

Abuzimi seksual ndodh në të gjitha shtresat e popullsisë, në zonat rurale dhe urbane, me nivele të ndryshme social-ekonomike dhe kulturore. Shkalla e dëmtimit të fëmijës varet nga natyra e abuzimit, moshja e fëmijës, dhe mjedisi që rrethon fëmijën. Dëmtimet që ka fëmija nuk janë vetëm dëmtimet e dukshme por edhe dëmtime të brendshme që e shoqërojnë fëmijën tërë jetën e tij / saj.

Shembull i abuzimit seksual është rasti i A, 12 vjeç, që ngacmohej seksualisht nga i ati. Një ditë nëna tregon se e gjeti babain të shtrirë mbi trupin e të bijës. Ajo reagon duke njoftuar policinë, ndërsa vetë largohet bashkë me fëmijët për në Strehëz.

Një tjetër shembulli është ai i një djali 3 vjeçar, që ngacmohej nga i ati, i cili e përkëdhelte vazhdimisht në organet gjinitale. Fëmija kishte mësuar të njëjtën sjellje dhe reagoonte në të njëjtën mënyrë ndaj njerëzve që e rrethonin.

Llojet e abuzimit seksual

✘ Veprime seksuale jo-prekëse, përfshijnë:

- ✦ Shfaqja ose tregimi i organeve seksuale;
- ✦ Ekspozimi i fëmijës përpara materialeve pornografike;
- ✦ Ekspozimi në mënyrë të qëllimshme i fëmijës i një marrëdhënieje seksuale;
- ✦ Mastrubimi përpara fëmijës.

✘ Veprime seksuale prekëse, përfshijnë:

- ✦ Ledhatimin, përkëdheljen e fëmijës, ose organeve seksuale të tij;
- ✦ Detyrimi / ftesa ndaj fëmijës që të prekë organet seksuale të një të rrituri;
- ✦ Çdo lloj penetrimi në vaginën ose anusin e fëmijës me objekte, të cilat nuk janë për qëllime mjekësore.

✘ Veprime seksuale shfrytëzuese, përfshijnë:

- ✦ Përfshirja e fëmijës në prostitucion;
- ✦ Përdorimi i fëmijës për filma, fotografi ose modele pornografike.

e) Neglizhenca ndaj fëmijës

Neglizhencë ndaj fëmijës do të konsiderohet mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm për fëmijën, si psh: streha, ushqimi, veshja, arsimimi, supervizioni, ndihma mjekësore si dhe çdo lloj tjetër ndihme bazë, që është e domosdoshme për zhvillimin e kapaciteteve fizike, intelektuale dhe emocionale të fëmijës. Në dallim nga abuzimi fizik dhe seksual, neglizhenca zakonisht përcaktohet si një model i papërshtatshëm i kujdesit ndaj fëmijës dhe që mund të shikohet çdo individ që është në kontakt me fëmijën. Mjekët, infermjeret, mësuesit, të afërmit ose komshinjtë janë ata që në mënyrë të vazhdueshme dyshojnë dhe duhet të raportojnë ëpr neglizhencën ndaj fëmijës.

B., 5 vjeç, shkon në spital me një djegje të shkallës së tretë në këmbë. Ajo ka shkuar në banjë dhe duke u

përpjekur të lahet vetë, ka hapur rubinetin e ujit të nxehtë duke shkaktuar djegje. Ndërkohë e ëma ndiqte serialin e telenoveles në orët e paradites. Ky rast është shembull i neglizhimit për t'u kujdesur për nevojat e higjienës bazë të fëmijës.

Y., 10 vjeç, nuk ka dëshirë të shkojë në shkollë pasi shokët e shajnë dhe tallen me të. Arësyeja është se ai mban era urinë. Djali urinon natën dhe nëna nuk kujdeset për higjienën e tij.

Në punën për identifikimin e formave të neglizhimit duhet të tregohemi të kujdesshëm pasi ato edhe mund të keqinterpretohen. Kështu, të gjithë fëmijët mund të ndoten kur luajnë dhe kjo është pjesë e eksperiencave të tyre të lojës, por kur fëmija nuk lahet e ndërrohet për kohë të gjatë, atëhere kemi të bëjmë me raste të neglizhimit.

Llojet e neglizhencës ndaj fëmijës

Neglizhenca fizike – është një nga format kryesore të keqtrajtimit. Neglizhenca fizike përfshin refuzimin ose dhënien me shumë vonesë të ndihmës së nevojshme mjekësore, lënia pas dore e fëmijës, kontrolli i papërshtatshëm, lënia mënjanë e fëmijës e cila mund të shkaktojë largimin e fëmijës nga shtëpia, ose mos dhënia e kujdesit dhe mbrojtjes së përshtatshme për fëmijën për të plotësuar nevojat etij fizike dhe emocionale. Neglizhenca fizike mund të ndikojë rëndë në zhvillimin e

fëmijës, duke i shkaktuar atij / asaj mungesë zhvillimi, kequshqyerje, sëmundje të rënda, dëmtim fizik në formën e prerjeve, djegieve dhe shenjave në trup, për shkak të mungesës së vëshgimit të fëmijës.

Neglizhenca edukative dhe arsimore – ndodh kur një fëmijë lejohet që të braktisë ose mos ndjekë shkollën, në një kohë kur ai / ajo është në moshën e detyrueshme për t'u shkolluar. Neglizhenca edukative dhe arsimore mund të shkaktojë mospajisjen e fëmijës me sjellje dhe njohuri bazë për t'u integruar në shoqëri, braktisjen përgjithmonë të arsimimit dhe shkollës, dhe / ose sjellje të vazhdueshme negative në shoqëri.

Neglizhenca emocionale - përfshin veprime të tilla si abuzimi i vazhdueshëm ose ekstrem ndërmjet prindërve në prezencë të fëmijës; lejimi i fëmijës të përdorë drogë ose alkool; refuzimi ose mos-dhënia e kujdesit psikologjik për fëmijën, përcmimi i vazhdueshëm dhe mos dhënia e afeksionit. Kjo mënyrë sjelljeje mund të sjellë imazh të keq për vetveten tek fëmija, abuzim me drogat ose alkoolin, dhe ndonjëherë edhe vetvrasje. Format më të rënda të neglizhencës mund të sjellin si pasojë mos-rritjen e fëmijës, keq-zhvillim ose vdekje.

Neglizhenca mjeksore - përfshin mosdhënien e ndihmës mjeksore për fëmijën, ndonëse familja ka mundësi financiare për ta ofruar këtë ndihmë. Në disa raste, prindi ose kujdestari mund të refuzojnë dhënien e ndihmës mjeksore të nevojshme gjatë praktikimit të besimit fetar. Neglizhenca mjeksore mund të sjellë si pasojë një shëndet të keq të fëmijës, si dhe probleme dhe sëmundje të vazhdueshme.

4. ABUZIMI I FËMIJËS DHE KONTEKSTI LIGJOR

4.1 Definicioni i fëmijës së abuzuar dhe neglizhuar

Në legjislacionin shqiptar mungon një definicion i qartë për abuzimin e fëmijës ose neglizhencës. Për këtë qëllim studiuesit në Kapitullin 3 të këtij studimi kanë shpjeguar në mënyrë të qartë se çfarë do të konsiderohet abuzim i fëmijës, cilat janë format e abuzimit dhe neglizhencës, dhe pasojat e tyre.

4.2 Legjislacioni shqiptar dhe abuzimi i fëmijës

Neni 54, Kushtetuta e Shqipërisë

Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën e zhvillimin e tij normal.

Ndonëse Kushtetuta e Shqipërisë shprehet qartë se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna dhe keqtrajtimi, duhet thënë se Neni 54 i Kushtetutës pak ka gjetur zbatim në vend. Legjislacioni penal dhe ai i familjes, ende kanë mangësi ligjore, që në realitet e bëjnë të pamundur mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi dhe neglizhenca. Siç do të shpjegohet më poshtë, një pjesë e këtyre mangësive ligjore, vijnë për shkak të mungesës së dëshirës politike nga ana e Qeverisë shqiptare dhe Parlamentit, mungësës së njohjes së fenomenit dhe pasojave që ai shkakton tek fëmija, si dhe mentalitetit të gjerë shoqëror se përdorimi i dhunës ndaj fëmijës ndihmon në edukimin dhe disiplinimin e tij / saj.

Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara

(1989) është instrument universal me rëndësi, dhe një hap i madh përpara për njohjen, respektimin dhe garantimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të fëmijës në të gjithë botën, përfshirë të drejtat e mbijetesës, të mbrojtjes dhe të zhvillimit të tyre. Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, ndonëse është një instrument ligjor i detyrueshëm për t'u marrë parasysh dhe zbatuar nga sistemi gjyqësor në Shqipëri, ende nuk ka gjetur zbatim të plotë në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë që sistemi i drejtësisë për të mitur është thuajse inegzistent, dhe fëmijët trajtohen në baze të legjislacionit të miratuar për të rriturit dhe jo për fëmijët.

Një mbrojtje e veçantë u garantohet fëmijëve në Kodin Penal, ku gjejmë dispozita të posaçme që garantojnë mbrojtjen e fëmijëve nga krimet kundër tyre. Megjithatë në bazët të dispozitave ekzistuese të Kodit Penal, fëmijës i garantohet mbrojtja nga krimet seksuale në familje. Por kjo mbrojtje nuk e shtrin veprimin e saj mbi të gjitha veprimet që mund të ndodhin mbi fëmijën, si psh: dhuna fizike, dhuna emocionale dhe neglizhenca.

Në Kodin e Procedurës Penale fëmijëve u janë garantuar disa të drejta themelore si p.sh: e drejta e fëmijës për të dëshmuar në procesin penal dhe për t'u pyetur; e drejta e realizimit të seancës gjyqësore me dyer të mbyllura, kur kjo ndikon në psikologjinë e fëmijës; e drejta për asistencë ligjore falas kur familjarët e tij nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet gjyqësore etj. Në praktikë mbetet shumë për të bërë, sepse gjykimi i çështjeve ku subjekt dhe objekt gjykimi janë të miturit nuk bëhet nga gjyqtarë të specializuar vetëm në këtë fushë dhe nuk është prezente ndihma e psikologut dhe punonjësit social në këto gjykime.

Në fushën civile i mituri fiton zotësi të plotë juridike me mbushjen e moshës 18-vjeç, por i mituri nën këtë moshë mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita. Gjithashtu Kodi Civil u garanton fëmijëve që nuk kanë mbushur moshën 14-vjeç, të drejtën për të kryer vetë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim, ndërsa veprimet e tjera juridike, në emër të tij i kryen përfaqësuesi ligjor.

4.3 Kodi i Familjes dhe Koncepti i 'Përgjegjësive Prindërore'

Kodi i ri i Familjes, i miratuar nga Parlamenti shqiptar, hyri në fuqi në 21 Dhjetor 2003, duke filluar nga zbatimi i tij në Janar 2004. Përgatitja e Kodit të Familjes, ndonëse

zgjati për një periudhë gjashtë vjeçare, nuk solli ndonjë trajtim të veçantë në çështjen e abuzimit të fëmijës, ndonëse pati përpjekje nga shoqëria civile që Kodi të bënte një trajtim dhe mbrojtje të drejtë të të drejtave të fëmijës. Sidoqoftë, Kodi i Familjes, përfshin disa koncepte të reja, të cilat ia vlen t'i marrim në shqyrtim dhe të shohim sesi ato mund të zbatohen për mbrojtjen e fëmijës së abuzuar.

a) Përgjegjësia Prindërore

Përpos detyrimit për ushqim dhe kujdesje, amësisë dhe atësisë, Kodo jep një sërë definicionesh, një nga të cilat është edhe 'përgjegjësia prindërore', e cila përkufizohet në nenin 215. Sipas Kodit, përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.

Në vështim të parë Neni 215 shfaq disa mangësi. Se pari aty mungon subjekti se kujt i drejtohet ky nen. Nuk është e qarte nëse kjo përgjegjësi prindërore bie mbi të dy prindërit, njërin prej tyre, kujdestarin, një të afërm etj. Megjithatë në nenin 220 Kodi përcakton se përgjegjësia prindërore ushtrohet nga të dy prindërit, ose njeri prej tyre.

Mangësia e dytë që vihet është se Neni 215 nuk kërkon respektimin e të drejtave të fëmijës, bile në një farë mënyre i kufizon ato vetëm tek mirëqenia emocionale, sociale dhe materiale, duke lënë të pambuluar mirëqenien fizike të fëmijës.

Së treti, një mangësi e theksuar që vihet re në këtë nen ka të bëjë me abuzimin e fëmijës. Neni nuk përdor terminologji ndaluese në rastin kur ushtrimi i të drejtave dhe detyrave e kapërcen pragun e sigurimit të mirërritjes, edukimit etj. Pyetjet që shtrohen për zgjidhje janë: ç'ndodh me prindin, i cili duke menduar se kujdeset për mirërritjen e fëmijës, edukimin ose administrimin e pasurisë së tij etj, përdor mjete ose metoda dhunuese ndaj fëmijës? A do të konsiderohet ushtrimi i dhunës ndaj fëmijës pjesë e ushtrimit të përgjegjësive prindërore? Kodi nuk i jep përgjigje këtyre pyetjeve, duke e lënë interpretimin e nenit të hapur nga zbatuesi i ligjit.

b) Humbja dhe Heqja e Përgjegjësisë Prindërore

Duke dashur t'i japim një përgjigje të drejtë pyetjeve të dhëna më sipër, u ndalëm në dy nene të Kodit të Familjes, të cilat trajtojnë 'humbjen e përgjegjësisë prindërore' dhe 'heqjen e përgjegjësisë prindërore', të cilat korrespondojnë me nenin 223 dhe nenin 228. Në pamje të parë krijohet përshtypja se 'humbja' është një masë me e lehte se 'heqja' e të drejtës prindërore, por në fakt kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme të sjelljes njerëzore. Në vetvete termi 'heq', në ndryshim nga termi 'humb' kërkon ndërhyrjen e një autoriteti më të lartë dhe që e ka të drejtën të marrë një masë të tillë, siç është gjykata psh. Një gjë që mbetet e pasqaruar në Kod është ndryshimi midis këtyre termave. A kanë 'humbja' dhe 'heqja' të njëjtin kuptim, kur rezultati final është që njëri ose asnjëri nga prindërit nuk do të jenë më përgjegjës për fëmijën e tyre?

Neni 223 përcakton kushtet se kur humbet përgjegjësia prindërore dhe kush e humbet atë. "Prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nepermjet një vendimi penal që i ka denuar ata si autore ose si bashkepunëtorë për një veprë penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkepunëtorë në një veprë penale të kryer nga fëmija i tyre..." - përcakton Kodi i Familjes. Pra kushti baze i 'humbjes' së përgjegjësisë prindërore në bazë të nenit 223 ka të bëjë me një sjellje kriminale të prindërve ose të fëmijës. Megjithatë edhe ketu dalin një sërë pyetjesh që mbeten të pasqaruara, si psh: Kush e merr vendimin e 'humbjes' së përgjegjësisë prindërore? A është vendimi i 'humbjes' së përgjegjësisë prindërore pjesë e vendimit penal? Çfarë ndodh me fëmijën, kur prindërve u 'humbet' përgjegjësia prindërore?

Neni 228 trajton çështjen e 'heqjes' së përgjegjësisë prindërore, duke përcaktuar edhe mënyrën sesi ajo mund të hiqet. Neni 228, paragrafi i parë thotë: "Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijës, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund ti hiqet përgjegjësia prindërore. Problemi i nenit 228, ashtu si neni 223, është se ai le pa përgjigje çështjen e abuzimit të fëmijës në familje. Në asnjë moment ky nen, ose ndonje nen tjetër në Kodin e Familjes, nuk i

japin zgjidhje pyetjes 'çfare ndodh me prindin abuzues' ose pyetjes tjetër 'a është mungesë e përgjegjësisë prindërore dhunimi i fëmijës?'

Neni 228 gjithashtu nuk jep ndonje përcaktim të qartë nëse veprimet e përmëdura në këtë nen, përbëjnë veprë penale, apo thjesht janë në kundërshtim me Kodin e Familjes. Se fundi, neni përjashton në mënyrë të pakuptueshme, një sërë subjektësh që mund të kërkojnë heqjen e përgjegjësisë prindërore. Një nga këto subjekte është 'punonjësi social' ose 'psikologu', gjë që e zvogëlon gamën e personave që mund të veprojnë në mbrojtje të fëmijës.

4.4 Politikat qeveritare dhe abuzimi i fëmijës


Strategjia Kombëtare për Fëmijët, e hartuar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila shprehimisht përcakton se fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të vaçantë nga shteti, si dhe të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, është një dokument i rendësishëm që përcakton objektivat strategjike të politikës së Qeverisë Shqiptare në këtë fushë të ndjeshme të zhvillimit tonë shoqëror. Megjithatë çështja e abuzimit të fëmijës zuri shumë pak vend në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët, gjë që do të thotë se në Shqipëri nuk ka politika qeveritare kundër abuzimit të fëmijës dhe rehabilitimit të tij.

Strategjia Kombëtare për fëmijët si dokumenti bazuar në këtë Konventë, rikonfirmon të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve me qëllim shndërrimin e saj në aksion kombëtar dhe detyruet, hartimin dhe ndryshimin nga Qeveria Shqiptare të ligjeve të brendshme të Shtetit për t'i përputhur ato me dispozitat e Konventës.

Përsa i përket formave të ndryshme të dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve në këto vite në Shqipëri krahas formave të trashëguara nga e kaluara si format e ndëshkimit të fortë prindëror, u shfaqën edhe disa forma të reja që përfshijnë prostitucionin, punën e detyruar të fëmijëve, trafikimin e fëmijëve, rrëmbimin e tyre, etj.

5. MBROJTJA E FEMIJEVE NGA ABUZIMI DHE NEGLIZHENCA

5.1 Skema e mbrojtjes, përkujdesjes dhe referimit për fëmijët e abuzuar dhe institucionet përgjegjëse



a) Policia e Shtetit

Policia e Shtetit dhe Komisarariatet e Policisë kujdesen për fëmijën e abuzuar në momentin që praën saj raportohet për raste të dhunës fizike ose seksuale ndaj fëmijes. Mungesa e një sistemi të mbledhjes të të dhënave nga Policia e Shtetit, e bën thuajse të pamundur studimin e rolit që luan Policia në mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve të abuzuar.

Roli kryesor i policisë dhe punonjësve të saj është marrja në mbrojtje dhe kujdes e fëmijës së abuzuar, hapja e procedurave penale për dhunuesin, gjetja e një avokati ose punonjësi social për fëmijën, si dhe referimi i fëmijes në një institucion të specializuar si shërbimi shëndetësor ose ai social. Megjithatë, meqënëse mungon fare infrastruktura e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijës së abuzuar ose neglizhuar, dhe për shkak të respektimit të procedurave, shpeshherë policia gjendet përballë faktit që është e detyruar ta dërgojë fëmijën në të njëjtën familje abuzuese.

Nga ana tjetër ka një mungëse të plotë të lidhjeve institucionale që duhet të egzistojnë midis policisë dhe

shërbimit social. Gjate punës së CRCA me institucionet e policisë, kemi vënë re se punonjësit e policisë nuk i njohin institucionet e përkujdesjes shtetërore dhe për më tepër nuk e kanë për detyrë të kërkojnë ndihmën e tyre. Shpesh është më e lehtë për punonjësit e policisë që të thërrasin në ndihmë shërbimet falas të OJF-ve (fakt ky që duhet vlerësuar), sesa shërbimin social shtetëror ose atë të Bashkisë. Punonjësi i policisë lihet i vetëm përballë fëmijës, duke mos patur në dispozicion asnjë lloj procedure ose manuali ndihmës, që mund t'i tregojë se kë duhet të kontaktojë dhe si duhet të silllet me fëmijën e abuzuar.

b) Shërbimet shëndetësore

Shërbimi shëndetësor ka për detyrë të kujdeset për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës dhe promovimin e një jetese të shëndetshme fizike, mendore dhe seksuale për fëmijën. Megjithatë, ndonëse abuzimi i fëmijëve përbën një problem shqetësues për shoqërinë, ende në sistemin shëndetësor mungojnë specialistët dhe infrastruktura e trajtimit, kujdesit dhe rehabilitimit për fëmijën e abuzuar.

Nga ana tjetër është detyrë e shërbimit shëndetësor që të bëjë edhe verifikimin e formës dhe pasojave të dhunës ndaj fëmijës, qoftë kjo fizike, seksuale, emocionale etj. Faktet e mbledhura dhe të çertifikuara nga mjeku përkatës janë ato që shërbejnë dhe merren në cilësinë e provës nga trupi gjykues, prokuroria ose policia.

c) Shërbimi social

Ndonëse behet kohë që Shërbimi Social është krijuar në Shqipëri, ende ai vazhdon të mbetet një dhënës i asistencës financiare, sesa një ofrues shërbimi në komunitet në ndihmë të personave në nevojë. Pranë Shërbimit Social Shtetëror, në nivel qendror dhe lokal, nuk ka asnjë lloj strukture që të jetë përgjegjëse për fëmijët në familje. Megjithëse ligji krijon mundësi ndërhyrjeje në rastet e fëmijëve të abuzuar, ato nuk janë shfrytëzuar.

Ndonëse Shërbimi Social është institucioni qeveritar drejtëpërsëdrejti përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar, deri më sot nuk ka patur asnjë rast të zbuluar, ndjekur, referuar ose menaxhuar nga ky institucion. Kjo tregon për mangësitë në burime njerëzore, financiare dhe në infrastrukturë të Shërbimit Social, i cili është ende larg të qenit afër komunitetit. Ky institucion është gjithashtu përgjegjës për krijimin e sistemit të referimit dhe menaxhimit të rastit, duke bërë pjesë të mandatit të tij, punën me policinë, shkollat, shërbimin shëndetësor, familjen, OJF-të etj.

d) Shkolla

Shkolla, e parë si një sistem më vete, duhet të luajë një rol të padiskutueshëm në evidentimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar. Meqë fëmija qendron për një periudhë relativisht të gjatë në shkollë, mësuesit janë ndër të parët që ndeshin pasojat e abuzimit tek fëmijët. Ndodh shpesh që mësuesit ankohen për sjellje të dhunshme ose jo-normale të fëmijëve, megjithatë shume rrallë ka ndodhur që këto raste të referohen tek punonjësit socialë në shkollë. Nëse trupa mësimore në sistemin shkollor merr trainimin e duhur, ajo mund të ndihmojë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi. Roli i mësuesit nuk është të trajtojë rastet e fëmijëve të abuzuar, por vetëm të referojë të gjitha rastet e ndryshimta tek personi i specializuar.

e) Sistemi i drejtësisë

Sistemi i drejtësisë është përgjegjës, jo vetëm për dhënien e drejtësisë dhe dënimin e dhunuesve të fëmijës, por njëkohësisht edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për marrjen e dëshmisë së fëmijës, dëgjimin e opinionit të fëmijës, si dhe kompensimin e fëmijës për dëmin që i është shkaktuar. Studimi i rolit të sistemit të drejtësisë dhe rasteve të gjykimit bëhet tepër i vështirë për shkak të mungesës të të dhënave. Nga ana tjetër mungesa e një gjykate të specializuar për çështjet e fëmijëve, bën që trajtimi dhe gjykimi i rasteve të fëmijëve të bëhet nga gjykatës të paspecializuar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Sistemi i drejtësisë ka nevojë të ndryshojë qëndrimin e tij ndaj fëmijës, duke krijuar mjedise dhe procedura të posaçme për një trajtim sa me miqësor të fëmijës.

f) OJF-të

Ndonëse roli i OJF-ve nuk është shkruar gjekundi, sigurisht që ato kanë një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e shoqërisë dhe Qeverisë (në nivel qendror dhe lokal) pasojat e abuzimit tek fëmijët. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet roli që shoqëria civile mund të luajë duke krijuar modele të shërbimeve të suksesshme si në hapjen e linjave të telefonit, shërbimeve ndihmëse etj.

g) Komuniteti

Komuniteti ka një rol të padiskutueshëm në evidentimin dhe raportimin e rasteve prane institucioneve përgjegjëse. Çdo lloj dhune ndaj fëmijës përbën një krim jo vetëm ndaj individit, por edhe shoqërisë. Komuniteti është prezent, sheh dhe vëzhgon raste të ndryshme jo vetëm të dhunës ndaj fëmijëve të ushtruara nga prindërit, por edhe sjelljen e fëmijëve, e cila ndonjëherë mund të duket e çuditshme ose nuk paraqitet si normale. Sot egzistojnë mundësi për komunitetin që të raportojë praën Policisë ose Shërbimit Social raste të ushtrimit të dhunës ndaj fëmijëve.

6. QËNDRIMI SOCIAL NDAJ ABUZIMIT TË FËMIJËS

Kur flasim dhe ekzaminojmë një problem të caktuar social, përgjithësisht ne fokusohemi në dy aspekte: aspektin objektiv dhe aspektin subjektiv. Aspekti objektiv përfshin përmasat reale dhe intensitetin e shkeljes së vlerave të pranuar nga shoqëria. Aspekti subjektiv përfshin shkallën se deri ku opinioni publik është i përgatitur të pranojë një problem të caktuar si problem social.

Për sa i përket aspektit objektiv të abuzimit të fëmijëve, ndonëse në kushtet e mungesës së të dhënave dhe shifrave të rregjistruara në vite, mund të thuhet pa mëdyshje se problemi është në përmasa shqetësuese. Ai rrezikon shumë fëmijë dhe të rinj. Njohuritë mbi aspektin subjektiv të problemit të abuzimit të fëmijëve duket se janë të rëndësishme lidhur me përshkrimin e mësipërm.

Njohja e qëndrimeve sociale rreth sjelljes që ka të bëjë me abuzimin e fëmijës na lejon të kuptojmë shkallën e pranueshmërisë nga shoqëria të politikave të caktuara sociale që kanë të bëjnë me këtë problem ashtu sikurse na ndihmon të dallojmë sjellje që pavarësisht se janë në kundërshtim me vlera të njohura, përbëjnë një standart të caktuar social.

6.1 Shkalla e pranueshmërisë nga shoqëria e abuzimit të fëmijëve në familje

Përdorimi i ndëshkimit trupor nga ana e prindërve përgjithësisht, pothuajse në të gjitha nivelet e shoqërisë sonë konsiderohet si një metodë e disiplinimit të fëmijëve, metodë e ushqyer nga tradita dhe e sanksionuar në zakone. Ky ndëshkim shpesh shoqërohet edhe me idenë se “është për të mirën e fëmijës” se nëpërmjet tij sigurohet bindja ndaj autoritetit të prindit dhe se kjo ndihmon në krijimin e konceptit të familjes. Këtij qëndrimi i bëhen mbështetje fjalë të tilla të urta si “dajaku ka dalë nga xehneti”, “druri i bën mirë fëmijës”, “sa më shumë të rrihet fëmija aq më i mirë bëhet”.

Krahas mbështetjes që i bëhet ndëshkimit trupor nuk mund të lihen pa përmendur disa diferenca që janë të lidhura me përkatësinë gjinore të fëmijëve.

Ndërsa për fëmijët djem ndëshkimi, veçanërisht nga nëna është më i kursyer, atyre iu ofrohen më shumë modele të sjelljeve të dhunshme. Këto modele i ofrohen kryesisht nga babai, por edhe nga lodrat dhe aktivitetet ndaj të cilave ata ekspozohen. Nëse vajzat kursehen më pak ndaj

ndëshkimit, ato mësohen edhe të pranojnë çdo lloj forme të dhunës që në moshat e vogla. Ato mësohen të jenë të urdhëruara, jokokëforte, tolerante, por njëkohësisht edhe të duruara. Si të tilla ato mund të jenë objekt i dhunës jo vetëm nga prindërit por edhe nga vëll

ezërit më të rritur apo pjestarë të tjerë të familjes. Kjo lloj difference në qëndrimin ndaj fëmijëve djem dhe vajza lidhur me ndëshkimin trupor e ka bazën tek diferenca në vlerësim që u bëhet djalit dhe vajzës në familje. Djali shihet si e ardhmja e familjes, trashgimtari i saj, ndërsa vajza duke qenë e destinuar për “derë të huaj” duhet të socializohet me karakteristikat e sipërpërmendura.

Për të ilustruar konkluzionin tonin do të dëshironim të përmendnim rastin e babait që ekzekutoi të bijën sepse ajo kishte shkuar me të dashurin e saj për të kaluar disa orë në një disko të Tiranës. Jo vetëm që babai pati kurajon të qëllonte mbi vajzën, por edhe e ëma nuk ngurroi të përpiquej ta mbulonte krimin dhe ta paraqiste atë si një vdekje natyrale të së bijës.

Cila është arsyeja e rrahjes së fëmijëve? Duke u përpjekur të merrnim disa përgjigje për këtë pyetje, në vite ne kemi kontaktuar me njerëz të profesioneve dhe niveleve të ndryshme. Na duket e rëndësishme të përmendim për këtë studim faktin se shumica e të kontaktuarve ndajnë të njëjtin opinion që e justifikojnë përdorimin e dhunës fizike në disa raste të veçanta. Në të tilla raste ato përmendin sjellje të pahijshme nga ana fëmijës, përdorim droge dhe alkoli, largimin nga shkolla, përvetësime të pasurive (para ose objekte me vlerë) të pjestarëve të tjerë të familjes apo njerëzve të panjohur. Dhuna e përdorur në këto raste konsiderohet si një mënyrë për edukimin e fëmijës.

6.2 Prindërit dhe pritshmëria e tyre nga fëmijët

Eksperienca e punës me rastet e fëmijëve të dhunuar na provon se dhuna ndaj fëmijëve ushtrohet nga prindër të dhunuar në fëmijërinë e tyre. E shprehur në një mënyrë më të përgjithshme do të thoshim “të dhunuarit dhunojnë”.

Rastet e dhunës tek fëmijët takohen në të gjitha shtresat dhe në rrethana nga më të ndryshmet, por rastet më ekstreme si dhe më shpesh të takueshme janë në familjet ku prindërit vijnë nga familje ku është ushtruar dhuna. Në të tilla raste dhuna është mësuar nga prindërit si një mjet

apo mënyrë për të zgjidhur problemet dhe përplasjet që mund të ndodhin brenda familjes. Adaptimi i modeleve të dhunshme të komunikimit, mungesa e tolerancës dhe e dashurisë në familje, humbja e kontrollit ndaj pjestarëve të familjes, çështje të tjera që lidhen me humbjen e pushtetit, abuzimet e ndryshme me drogat dhe alkolin, problemet e shëndetit mendor, mungesa e informacionit psiko-social lidhur me zhvillimet moshore tek fëmija, janë vetëm disa nga shkaqet që çojnë në përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve.

Një nga faktorët që mendojmë se është me interes për t'u theksuar në kuadrin e këtij studimi dhe që kontribuon në nxitjen e dhunës që ushtrohet ndaj fëmijëve është mundesa e realizimit nga ana e prindërve në krijimin e pritshmërive ndaj fëmijës.

Ajo që ndodh në praktikën e marrëdhëniesve prind-fëmijë është se një pjesë e prindërve duke pasur një fëmijëri të tyre të vështirë, kërkojnë tek fëmijët e tyre ose presin që fëmijët e tyre të kenë ose të bëhen ata që vetë prindërit nuk mundën të arrinin në jetë për arsye objektive apo subjektive. Pritshmëria e prindërve nuk merr parasysh mundësitë e fëmijës, kapacitetin e tyre, mjedisin, vlerat në ndryshim, raportet e reja e të tjerë faktorë psiko social që ndikojnë tek fëmijët tanë sot. Të prirur nga këto pritshmëri, prindërit investojnë dhe sakrifikojnë, ndonjëherë edhe përtej mundësive të tyre reale, por rezultati që vjen nga fëmijët nuk është i tillë që të kënaqë këtë investim. Ndodh në të tilla raste ajo që shpesh quhet zhgënjim i prindërve ose diferencë midis pritshmërive dhe rezultateve.

Ky lloj zhgënjimi mund të takohet që në moshë fare të reja, kur fëmija fillon të shkojë në kopësht apo që në klasë të parë. Nuk përjashtohen raste kur burim zhgënjimi janë edhe lindjet e fëmijëve me probleme apo anomalitë që fitohen gjatë jetës. Të ndodhur në të tilla situatë jo të pëlqyeshme, një pjesë e prindërve, duke mos qënë në gjendje të menaxhojnë stresin që krijohet tek ata, duke e shkarkuar atë tek fëmijët me forma dhe metoda të dhunshme.

Në fakt, kështu ka nisur të instalohet ajo që në psikologji njihet si "lufta guerrile" brenda familjes. Prindërit dhunojnë njëri-tjetrin dhe fëmijët. Fëmijët mësojnë nga sjellje të tilla dhe dhunojnë njëri-tjetrin dhe edukohen si dhunues të së ardhmes.

6.3 Shkalla e pranueshmërisë së abuzimit nga fëmijët

Për të gjithë fëmijët dhuna është shokuese, aq më tepër që ajo vjen nga prindërit, njerëzit më të dashur për ata dhe që pritet që të kujdesen dhe t'ju ofrojnë dashuri dhe përkushtim. Fëmijët humbasin besimin tek prindërit. Kjo është goditja e parë që ata marrin, në një kohë që pritet që ata të krijojnë besim tek njerëzit e tjerë nëpërmjet besimit që ata kanë ndaj prindërve.

Më pas ndodh ajo që quhet përshtatje me dhunën. Fëmijët mësohen ta perceptojnë dhe përjetojnë atë si një mënyrë më se normale të rritjes dhe edukimit të tyre. Nëse krahasojmë reagimet e mbledhura nga individë të rritur me ato të vetë fëmijëve për ndëshkimin dhe abuzimin e tyre nga prindërit, të bie në sy fakti se edhe fëmijët shprehen në një nivel të lartë për justifikimin e dhunës që ushtrohet ndaj tyre. Opinione të tilla tregojnë se tek fëmijët është edukuar mendimi se rrahja, ndëshkimi trupor, përdorimi i forcës, janë metoda normale që prindërit i përdorin për edukimin e fëmijëve. Këto qëndrime duket se janë rezultat i ndikimit të prindërve më tepër sesa rezultat i qëndrimeve të vetë atyre për problemin. Natyrisht, në një qëndrim të tillë kanë ndikimin e tyre edhe vlerat dhe qëndrimet mbizotëruese në shoqëri, ndonëse është fakt që shtimi i informacionit të fëmijëve për të drejtat e tyre, i ka bërë këta të fundit më të ndjeshëm dhe më pak tolerues ndaj dhunës.

6.4 Këndvështrimi i profesionistëve për fenomenin

Këndvështrimi i profesionistëve konsiston në dy komponentë: nevoja e ndërhyrjes në mbrojtje të fëmijës – viktimë dhe, nevoja e ndërhyrjes ndaj prindit – dhunues.

Ndërsa shoqëria shqiptare nuk duket ende e bindur për domosdoshmërinë e ndërhyrjes në rastet e dhunës ndaj fëmijëve, profesionistët duket se e konsiderojnë detyrë ndihmën ndaj viktimave të dhunës familjare. Sipas tyre ndërhyrja e institucioneve është e domosdoshme kur një fëmijë vuan fizikisht, psikologjikisht dhe seksualisht, si rezultat i dhunës që ushtrohet ndaj tij. Për ta ndërhyrja është e domosdoshme edhe në rastet kur fëmija është i neglizhuar.

Pavarësisht mendimit popullor që në këto raste "është më mirë të mos ndërhyhet", sepse kjo mund ta rëndojë situatën e fëmijës – viktimë, profesionistët shprehen në mënyrë të prerë se në këto raste duhet ndërhyrë. Ky

mendim duket mbizotërues tek punonjësit socialë, psikologët, dhe edukatorët.

Fatkeqësisht nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me ta punonjësit e shëndetësisë, shërbimit social dhe ata të policisë. Kategoria e dytë ndoshta është më pak e ndërgjegjësuar për pasojat e dhunës ndaj fëmijëve dhe mbeten të fokusuar vetëm në shërbimet e tyre primare. Në disa raste ndjehet tek ata frika e përfshirjes në procese gjyqësore që nuk dëshirohen prej tyre.

Komponenti i dytë që ka të bëjë me qëndrimin ndaj prindërve paraqitet më kompleks. Ai nuk i shpëton mendimit mbizotërues që deri diku e justifikon dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve. Megjithatë profesionistët e shohin si domosdoshmëri ndërhyrjen për të ndihmuar dhunuesin.

Fatkeqësisht në Shqipëri ende nuk ekziston një legjislacion që të përcaktojë ndërhyrje përveçse në rastet e dhunës ekstreme. Ajo që ekziston sot në nivelet e politikave, legjislacionit dhe shërbimeve nuk mund të mbrojë kurrësesi fëmijët e rrezikuar. Profesionistët shprehin se ndërhyrja nga ana e tyre vështirësohet edhe për faktin se mungojnë shërbimet e specializuara për trajtimin e dhunuesve. Të tilla shërbime do të ndikonin për të parandaluar numrin e lartë të rasteve të fëmijëve të abuzuar, por edhe shkallën e dhunimit.

Shumica e profesionistëve janë kategorikë në mendimin se në Shqipëri mungon një sistem përkujdesjeje për fëmijët viktime të dhunës dhe neglizhencës në familje. Të vetmet shërbime janë ato që ofrohen nga disa organizata ose grupime që kanë marrë përsipër të mbrojnë të drejtat e fëmijëve, apo dhe të trajtojnë fëmijë, viktime të dhunës në familje. Edhe ky shërbim ndonëse i specializuar nuk mbështetet nëpërmjet politikave osed financimeve publike. Është ndjeshmëria e tyre, filozofia dhe formimi i tyre që e ka mundësuar këtë lloj aktiviteti.

7. SHKALLA E PERHAPJES SË ABUZIMIT TË FËMIJËS

7.1 Përmasat e fenomenit

Duke u përpjekur të identifikojmë përmasat e fenomenit në shoqërinë tonë, na duhet të theksojmë se objekt i këtij studimi janë fëmijët e nënave të abuzuara. Pra, në këto kushte është e vështirë të jepem konsiderata të përgjithme, por e ndiejmë më vend të theksojmë se eksperinca e punës në Strehëzën për Gratë e Dhunuara, ka ndihmuar të kuptohet fakti se të rrezikuar nga dhuna dhe abuzimi janë të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha, vendbanimi, gjinia, niveli social - ekonomik i familjes dhe statusi i saj. Ka një aspekt ku duhet të ndalemi dhe ky është fakti që në shërbimin e Strehëzës janë afruar më shumë fëmijë nga familje të varfëra, pa përkrahje, me mjete jetese të kufizuara ose të munguara, me status social të lëkundur. Ky fakt në asnjë mënyrë dhe për asnjë arsye nuk mund të mbulojë edhe shumë fëmijë të tjerë që vijnë nga familje në gjendje ekonomike të mirë dhe që ekzistenca e burimeve të mjaftueshme ju mundëson ose lehtëson fshehjen e problemit për momentin, por kurrësesi mbulimin e tij.


Fëmijët bëhen viktime të drejtëpërdrejta ose të tërthorta të abuzimit. Ata në shumicën e rasteve kanë qënë prezent në momente të ushtrimit të dhunës ndaj pjestarëve të tjerë të familjes, kryesisht të nënës. Ata kanë përjetuar me nota të dhimshme dhunimin e njeriut të tyre të shtrenjtë, janë përpjekur të bëhen mbështetës të saj, kanë urryer dhunuesin, por njëkohësisht e kanë patur të vështirë ta flakin ose braktisin atë. Ata kanë jetuar momente dilemash të vështira për moshën dhe eksperiencën e tyre. Në të tilla mjedise të dhunshme nuk ka qënë rastësi që ata të jenë bërë objekt i drejtëpërdrejte i abuzimit fizik të ushtruar mbi ata nga babai, nëna ose vëllai më i rritur. Shumë nga fëmijët e abuzuar janë edhe viktime të abuzimit emocional.

Përgjithësisht fëmijët vijnë nga familje problematike: prindër të divorcuar, prindër të rimartuar, prindër me probleme sociale, me probleme të shëndetit mendor, me probleme social ekonomike, me probleme të personalitetit, etj. Por, kjo nuk do të thotë se fëmijët e grupeve të tjera sociale, nuk janë të rrezikuar nga dhuna.

7.2 Profili i familjeve abuzuese

Vendbanimi

Shumica e rasteve vijnë nga zona të ndryshme të vendit, por edhe ato që vijnë nga Tirana, janë vendosur në Tiranë




gjatë viteve të fundit. Rrethet nga vijnë shumica e klienteve janë: Berati, Lushnja, Shkodra, Lezha, Korça, Dibra, Pogradeci, Elbasani etj, të cilat ne i kemi paraqitur në grafik të grupuara sipas zonave gjeografike, Shqipëri e Veriut, Shqipëri e Jugut, Shqipëri e Mesme apo zona të tjera jashtë kufijve.

Kjo e dhënë tregon se më të ekspozuar ndaj abuzimit janë fëmijët që jetojnë në rrethe problematike, pak të zhvilluara, të mbërthyer nga problemet sociale ose fëmijët e familjeve që janë vendosur në Tiranë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit

a. PROFILI I NËNËS

Arsimi i nënave

Rreth 80 % e klienteve të trajtuara në Strehëz kanë arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm, ku predominon arsimi tetëvjeçar me 46%. 10% i tyre kanë arsim fillor dhe 9% arsim të lartë.




Abuzimi nuk kursen asnjë shtresë sociale me nivele të ndryshme arsimimi. Në këtë rast theksojme se dhuna ndodh më shpesh tek familjet me nivel të ulët arsimor, pasi ato nuk siguron mundësi të mjaftueshme për të përballuar kërkesat për jetën.

Në të tilla familje niveli i stresit për të mbijetuar është më i lartë dhe ai bëhet shkak për kapërcimin e kufijve dhe dëmtimin e njerëzve të dashur.

Statusi civil i nënave

Rreth 50 % e nënave kanë qënë të lidhura me martesë, 10% të divorcuara ose në bashkëjetesë, rreth 40% kanë qënë vajza ose gra të pamartuara.

Fakti që shumica e nënave vijnë nga familje të mbështetura në martesë tregon se edhe rastet më të shumta të abuzimit takohen brenda gjitit të familjes.




Ndërkohë divorci, ankthi i divorcit, pasiguria nga bashkëjetesa, fëmijët e ardhur në jetë nga bashkëjetesa dhe të padëshiruar, përbëjnë një rrethanë tjetër që rrit frekuencën e abuzimit.

Numri i fëmijëve për çdo familje

Shumica e klienteve kanë ardhur në Strehëz me fëmijë, rreth 70 % e tyre. Numri i fëmijëve ka variuar nga 1 – 4. 25% kanë qënë pa fëmijë dhe 6% kanë qënë shtatëzënë jashtë martese ose pa kurorë dhe kanë lindur fëmijët e tyre gjatë qëndrimit në Strehëz. Në shumicën e këtyre rasteve fëmijët janë abandonuar duke ndjekur praktikën e dhënies së fëmijës për birësim. Një vendim i tillë është marrë nga vetë vajzat – nëna nën presionin e madh të familjeve të tyre. Në shumicën e rasteve fëmijët e nënave të abuzuara kanë qënë vetë të abuzuar.

Punësimi



Shumicën e klienteve, rreth 38% e përbëjnë gratë me profesion punëtore, 30% janë të papuna, 13% profesioniste të mesme, 11% profesioniste të larta, 4% rezultojnë shtëpiake dhe 4% janë studente. Në rastin e grave të papuna, në dallim nga ato shtëpiake, duhet të theksojmë se të parat e kanë humbur punën, kurse gratë shtëpiake na rezultojnë të mos kenë punuar kurrë jashtë shtëpisë, por preokupimi i tyre i vetëm ka qenë kujdesi për familjen. Siç kuptohet nga të dhënat e mësipërme shumica e klienteve kanë bërë punë të niveleve të ulta. Kjo gjë nuk ka lejuar zhvillimin e shprehive të tyre të punës, dhe për pasojë shumica e tyre e kanë të vështirë të konkurojnë në tregun e sotëm të punës.

Statusi i punësimit të nënave mendohet se ndikon drejtpërsëdrejti në frekuencën e abuzimit të nënave. Nënata që vuajnë nga varësia ekonomike, që nuk janë të kënaqura me punën që bëjnë, që janë të tej lodhura nga puna, që janë të pakënaqura nga statusi dhe lloji i tyre i punës, apo që janë të mërzitura nga qëndrimi i tyre mbyllur në shtëpi kanë gjithmonë rrezikun e të abuzuarit me fëmijët e tyre në të gjitha format e përmendura më sipër.

b. PROFILI I BABAIT

Në përpjekje për të vizatuar profilin e babait të dhunshëm do të përdorim ato të dhëna që rezultojnë të grumbulluara nga bisedat me fëmijët ose nënat e tyre për problemet e dhunës.

Në shumicën e rasteve të fëmijëve të trajtuar, babai rezulton të jetë i papunë (mbi 70% e rasteve). Në këto kushte ata kanë probleme të vetvlerësimit, përjetojnë humbje të autoritetit, humbje të statusit të kryetarit të familjes dhe përpiqen të rikthejnë autoritetin e tyre duke dhunuar pjestarët e familjes së tyre.

Babai abuzues ka probleme të alkoolit, drogës dhe sipas të dhënave që disponohen në Strehëz, ata luajnë lojra fati, ku humbasin të ardhurat e familjes, paratë e ushqimit dhe reagojnë me dhunë ndaj kritikave të familjarëve. Këta baballarë përveçse ju ofrojnë fëmijëve të tyre modele parazitizmi, sjellje të rrezikshme për qëndrueshmërinë e familjes, bëhen edhe burimi kryesor i të gjitha formave të abuzimit.

Mendojmë se është me interes të theksojmë se një kategori jo e vogël e babait dhunues janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme (si trafikim të qënieve të njerëzore, trafik droge, falsifikim dokumentash) ose kanë biznese të paligjshme. Ata janë vazhdimisht jo vetëm në ankthin e humbjes së pronave të tyre të paligjshme, në ankthin e arrestimit, dështimit, por edhe në ankthin e lidhjeve jashtë-martesorë. Kjo kategori përbën deri në 30% të rasteve. Nuk mungojnë edhe rastet e baballarëve të sëmurë mendorë.

8. PROFILI I FËMIJËVE DHE PASOJAT E ABUZIMIT

8.1 Profili i fëmijëve të abuzuar

Mosha e fëmijës

Fëmijët e trajtuar në Strehëz përgjithësisht kanë qenë të moshave të ndryshme. Shpërndarja është afërsisht në nivele të barabarta: 28 % kanë qenë të grupmoshës 0-3 vjeç, nga të cilët rreth ½ e tyre kanë lindur në Strehëz. 15% e fëmijëve i përkasin grupmoshës 4-6 vjeç, 24% grupmoshës 7-10 vjeç dhe 19% grupmoshës 11-14 vjeç. Siç shihet edhe nga shifrat, dhuna nuk ka përrjashtuar fëmijët e asnjë grupmoshe, ata bëhen viktimë pavarësisht nëse janë mjaft të vegjël apo edhe relativisht të rritur.

Gjinia

Fëmijët e abuzuar kanë qenë si djem dhe vajza në një raport pothuaj të njëjtë, konkretisht 47% vajza, 53% djem. Mund të dallojmë këtu që djemtë raportojnë më tepër abuzim fizik sesa vajzat, ndërsa rastet e abuzimit seksual janë raportuar kryesisht tek vajzat.

Lloji i dhunës

Përsa i përket llojit të dhunës që është ushtruar tek fëmijët ajo ka qenë e të tre llojeve të përmenduar më lart. Kështu 20 % e fëmijëve rezultojnë se janë abuzuar fizikisht, 3 % e tyre seksualisht ku përfshihen rastet e molestimit, ngacmimit nga babai, ndërsa 100 % e fëmijëve deklarojnë se kanë përjetuar dhunë emocionale.

8.2 Pasojat e abuzimit tek fëmijët

Mbështetur në rastet e fëmijëve të trajtuar mund të arrihet në disa konkluzione të përgjithshme lidhur me pasojat e abuzimit tek fëmijët. Fëmijët e dhunuar pavarësisht nga forma e dhunës së ushtruar mbi ta, kanë eksperiencë të ngjashme ose afërsisht të ngjashme.

Një nga këto eksperiencë është dëmtimi emocional i fëmijës. Fëmija i dhunuar fizikisht, psikologjikisht por edhe seksualisht vuan emocionalisht nga kujdesi jo i vazhdueshëm prindëror dhe nga frika e dhunimeve të tjera që mund të pasojnë. Këta fëmijë vuajnë neglizhimin

emocional, mungesën e afeksionit dhe lidhjeve të fuqishme me prindërit. Në rastin e dhunës seksuale, ata i tremben faktit që mbeten në duart e dhunuesit për të plotësuar nevojat e tyre emocionale

Fëmijët e neglizhuar vuajnë mungesën e kujdesit për të plotësuar nevojat e tyre emocionale.

G. është një fëmijë katër vjeç që vjen në Strehëz së bashku me nënën e tij. Të dy janë të dhunuar nga babai dhe bashkëshorti. Ai kishte ushtruar dhunë ndaj gruas edhe në sy të fëmijës. Djali ishte i terrorizuar. Ai shqetësohet për fatin e nënës por edhe të atij vetë. Shpesh ai shprehet për të atin "pu, pu, ai është i tmerrshëm, ai të vret me thikë". Sikur të mos mjaftonte kjo, ai merrte edhe kërcënime të vazhdueshme nga e ëma, e cila e kërcënonte në çdo rast për ta braktisur. Në këto kushte ai vetëm e përkëdhelte nënën, i bënte vlerësime maksimale "ti je mami më e bukur në botë", "ti je ylli im", "je më e bukura në botë", e ledhatonte dhe përpiqej të mos e mërziste kurrë. Ndryshe nga bashkëmohatarët e tij, ai kujdesej jashtëzakonisht mirë për veten, hante vetë dhe pa naze, vishej vetë, kujdesej për gjërat e tij. Shqetësimi i tij mbetej që mami të mos lodhej dhe mërzitej.

Shembulli i mësipërm por edhe shembuj të tjerë tregojnë se këta fëmijë marrin përgjegjësi të parakohshme mbi vete. Ata bëhen përgjegjës për sjelljen e tyre, kujdesen për lumturinë dhe qetësinë e prindërve, kujdesen për vëllezërit dhe motrat, ngushëllojnë nënën e trishtuar, bëjnë të gjitha punët e shtëpisë, dhe përpiqen jashtë mundësive të tyre për ta mbajtur familjen të bashkuar.

M. është një fëmijë trembëdhjetë vjeçar i zhvilluar mirë fizikisht dhe psikologjikisht. Ai është shumë i zgjuar dhe shkëlqente në shkollë, është i heshtur, shumë i pjekur për moshën dhe komunikon rrallë. I vetmi shqetësim i tij ishte se si të bashkonte prindrit. Negocionte shpesh me të ëmën dhe i kërkonte takime herë pas here të atit. Çuditërisht ai nuk bënte rolin e përcjellësit të mesazheve nga njëri tek tjetri prind por iu kërkonte të dyve bashkimin sa më të shpejtë.

Kjo kategori fëmijësh përveç sa më sipër, marrin përgjegjësinë të përcaktojnë se kur mund t'i afrohen prindit dhe kur jo. Ata gjithashtu marrin përsipër dhe përpiqen të shmazin grindjet në familje. E gjithë kjo i kushton shumë këtyre fëmijëve. Në një mënyrë apo në një tjetër atyre kështu iu është mohuar fëmijëria.

R. është 12 vjeç, i zhvilluar mirë, por shumë i ndrojtur dhe shumë i edukuar. Edukata që ai shprehte e bënte atë të veçantë ndër fëmijët e pranishëm në Strehëz, por edhe mes shumë rasteve të trajtuara në këtë shërbim. Ai ishte shumë i lidhur me nënën dhe përpiquej të ishte perfekt në çdo gjë që bënte në mënyrë që të mos e mërzihte atë. Ai ndjehej i turpëruar nga sjelljet e të atit dhe nuk preferonte të fliste për të edhe kur një gjë e tillë i kërkohet nga punonjëset. Gjithë bota e tij ishte përqëndruar tek vizatimet ku me sa duket edhe shprehte emocinet e tij. Shqetësim i tij ishte mirëqënia dhe humori i mirë i nënës së tij. Duke qënë se ai kishte qënë prezent në shumë raste kur i ati dhunonte të ëmën, por edhe atë vetë, ai përpiquej me çdo kusht ta mbante nënën në humor të mirë.

Fëmijët e dhunuar karakterizohen nga mungesa e besimit ndaj njerëzve që i rrethojnë ata. Kjo shpjegohet me faktin se duke qënë të dhunuar nga individë të tillë që presupozohen të kujdesen për ata, fëmijët nuk mundet të krijojnë marrëdhënie besimi me njerëz të tjerë. Kjo është një karakteristikë e takuar pothuaj tek të gjithë fëmijët që janë trajtuar në Strehëz, por për qëllime ilustrimi do të sjellim rastin e dy fëmijëve, motër e vëlla nga Tirana.

Fëmijët e dhunuar karakterizohen nga dëshira për të mos kërkuar ndihmë. Kjo mbase është e kushtëzuar nga eksperiencat e tyre, kur askush nuk është kujdesur për ata. Në të tilla rrethana ata janë mësuar të kujdesen për veten, për nevojat e tyre dhe normalisht ta konsiderojnë këtë një përgjegjësi të tyren. Ata janë fëmijë që nuk dinë të qajnë e të ankohen. Ata përpiquej të gëzojnë gjithcka që mund t'ju afrohet, pa patur shumë pretendime.

Përgjithësisht këta fëmijë formojnë karaktere të mbyllura, jo të komunikueshëm, vuajnë shumë brenda vetes, ndajnë shumë pak ose aspak nga eksperiencat e tyre të dhimbshme me të tjerët. Ata ndjehen të turpëruar nga situata në familjen e tyre dhe përpiquej me çdo kusht që ta mbulojnë këtë problem. Është kjo arsyeja që ata bëhen të ftohtë, të egër dhe shpërthyes të paparashikueshëm. Në

disa raste ata janë apatikë, pa dëshira, ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre, pa iniciativë dhe inatçorë.

B është 3-4 vjeç. Ai është shumë i lëvizshëm, i papërqëndruar dhe të bën përshtypje se ai nuk flet, por therret. Ai therret kur ka nevojë për diçka, edhe kur i thua diçka, dhe të duket se në mënyrën e tij të komunikimit ka zënë vend vetëm thirrja. Kur e merr në krah për ta përkëdhelur duhet të jesh shumë i kujdesshëm se ai mund të të qëllojë fare pa pritur edhe kur mendon se nuk ka asnjë arsye për një sjellje të tillë.

Një karakteristikë tjetër e fëmijëve është se ata vuajnë nga çrregullime të të ngrënit. Disa vuajnë nga anoreksia dhe disa të tjerë nga mbingrënia. Fëmijët duket se refuzojnë të ngrënit si shenjë hakmarrjeje për dhunimin e drejtëpërdrejtë apo të tërthortë që ju bëhet.

Fëmijët krahas problemeve të tjera kanë edhe probleme me urinimin. Pavarësisht nga mosha, një pjesë e mirë e tyre, veçanërisht në fazën e parë të vendosjes në strehëz, vuajnë nga urinimi gjatë natës. Në asnjë rast ky problem nuk ka qënë i lidhur me probleme shëndetësore. Ai ka qënë problem i lidhur me çrregullimet emocionale të tyre. Në shumicën e rasteve nënat shprehen se problemi nuk ka qënë i vazhdueshëm. Problemi ka filluar të shfaqet kur ka filluar të përjetohet edhe problemi në familje. Pra, këta fëmijë, dikur në fëmijërinë e tyre, e kanë fituar aftësinë për të kontrolluar nevojat personale. Me kalimin e viteve, si rezultat i problemeve emocionale të tyre, ata kanë humbur aftësinë e kontrollit të urinimit.

M dhe E janë dy motra përkatësisht 6 dhe 4 vjeç. Nëna e tyre tregon se vite më parë ato nuk e kanë patur këtë shqetësim. Gjithshka ka filluar kur babi i tyre është kthyer nga emigracioni i gjatë dhe ka dyshuar për sjelljen e bashkëshortes. Ai është bërë tepër agresiv, dyshues dhe kërcënues. Ai e dhunonte fizikisht të shoqen çdo dite pasi e kishte marrë në pyetje për orë të tëra për t'i treguar të dashurin e saj. Vajzat ishin prezent gjatë gjithë kohës. Ai arrinte sa ta kërcënonte të shoqen me armë zjarri dhe me thikë se do t'i merrte jetën në se ajo nuk i tregonte kush ishin të dashurit e saj. Vajzat, përveç problemeve të tjera, kishin filluar urinimin gjatë natës, duke e rënduar situatën e tyre që edhe pa këtë problem ishte mjaft e rënduar.

Midis fëmijëve të dhunuar, takohen edhe fëmijë që kanë tregues të prapambetjes mendore, fillimisht të moderuar, por që po nuk u trajtuan ajo mbart rrezikun e përkeqësimit, duke kaluar në nivele më të avancuara dhe më të rënduara të prapambetjes mendore.

D. është një vajzë në moshën 7 vjeçare. Ndonëse ka arritur moshën shkollore nëna e saj e mbytur në probleme, por edhe e ndërgegjshme deri në një farë mase për prapambetjen e së bijës, ka vendosur të mos e dërgojë në shkollë. D ka ardhur në jetë nga një lindje normale, por fill pas lindjes së saj kanë filluar problemet për prindërit. Babai humb punën dhe i vihet pijes. E ëma përpigjet që të punojë më shumë për të kompensuar papunësinë e të shoqit. Ajo dypunësohet dhe kujdesin për fëmijën e lë në duar të nënës së saj. D. sëmuret shpesh në foshnjërinë e saj, nuk merr mjekime, dhe kjo situatë çon në një zhvillim të vonë motor fillimisht (D. ngrihet në këmbë vetëm kur bëhet 2 vjeç). D. ka një fjalor tepër të varfër, me dialektin e gjyshes, tepër të pa zhvilluar për moshën e saj. D. ka vështirësi në shqiptim, gjë që bëhet pengesë për zhvillimin e të folurit. Në tërësi ajo ka një prapambetje të lehtë në koordinimin e proceseve mendore që janë rezultat i problemeve dhe mangësive në vitet e foshnjërisë. Sikur të mos mjaftonin të gjitha sa më sipër, babai i saj vdes nga mbidoza e alkoolit dhe nëna e vajza nxirren në rrugë nga njerëzit e babait. D. sikur e ndjen këtë humbje dhe gjatë gjithë kohës kërkon babain e saj. Tashmë kontaktet me nënën janë rralluar edhe më shumë pasi asaj i duhet të punojë për të mbijetuar.

Fëmijët e abuzuar përjetojnë një ndërprerje të procesit normal të rritjes së tyre fizike dhe psikologjike. Kjo ndërprerje mund të shprehet në formën e kapërcimit të fazave të rritjes ose të fiksimit në një fazë të hershme të zhvillimit.

9. RASTE STUDIMORE

Rasti A

G. është një fëmijë i seksit mashkull, 4 vjeç, i ardhur në jetë nga bashkëjetesa e prindërve të tij mjaft të rinj në moshë. Nëna kishte qënë vetëm 17 vjeç kur ka lindur djalin. Ajo vetë vjen nga një familje disfunktionale, me prindër të divorcuar dhe deri në një farë mase e abandonuar. Me shpresën për të filluar një jetë më të mirë familjare, ajo vendos të ikë nga shtëpia e prindërve të babit, ku jetonte prej disa vitesh, dhe të bashkëjetojë me një djalë të ri në moshë, jo më shumë se 20 vjeç, i cili njihet në komunitet si i “fortë”. Shumë shpejt ajo mbetet shtatëzënë dhe kjo e shqetëson pa masë partnerin, që me sa duket nuk kishte qëllime serioze. Me lindjen e djalit problemet acarohen më tej. Babai ikën nga shtëpia për ditë e javë të tëra. Kur kthehet e rreh dhe e dhunon nënën e G. Madje ajo shpesh është kërcënuar me jetën. Ndërkohë që askush nuk merrte përsipër ta mbronte ose ta strehonte, ajo i drejtohet Strehëzës për Gratë e Dhunuara. G. e shoqëronte nënën e tij që në takimin e parë. Ai nuk pranoi në asnjë mënyrë të ndahej nga e ëma qoftë edhe për pak kohë sa ajo të kryente procedurat e pranimit. G. dukej i terrorizuar dhe ndiqte me sy çdo lëvizje të nënës së tij. E ëma fliste, tregonte për dhunën që ushtrohej ndaj saj dhe shpesh përsëriste “pyeteni dhe djalin, po deshët” dhe drejtohej nga ai. G. si një i rritur pohonte me kokë që sa të linte të kuptohej që ai kishte qënë prezent në të gjitha rastet dhe kishte përjetuar gjithshka.

Me sistemimin në Strehëz gjërat u duken se po qetësoheshin fillimisht, ndërkohë që nënë e bir filluan të reflektonin pasojat e dhunës së ushtruar mbi ata. G. ndonse ishte i zhvilluar mirë fizikisht, vinte i imët. Sikur dhuna dhe dhimbja e kishin ndrydhur trupin e tij të njomë. Ai ishte i qetë përgjithësisht, por nuk fliste kurrë pa hedhur një vështrim aprovues nga e ëma. Ai ishte mësuar t’i dilte asaj në mbrojtje në të gjitha mënyrat. Kurrë nuk e shqetësonte. Ngrihej nga gjumi dhe priste me orë të tëra në shtrat derisa e ëma t’i jepte leje të lëvizte. Kujdesej për çdogjë vetë. Vishej, hante dhe lante duart vetë. Kurrë nuk bënte naze. Fjala e nënës ishte ligj për të. Dalëngadalë u zbulua se kjo sjellje lidhej me kërcënimet që i bënte herë pas here se edhe ajo si i ati mund ta brakiste. E lodhur nga hallet e saj, e vetme në një situatë të tillë, pa asnjë lloj mbështetjeje, e mbytur nga ndenja e fajit për një vendim të gabuar dhe të nxituar, ajo shkarkonte të gjithë ngarkesën emocionale tek i biri, që

ishite i vetmi njeri me të cilin ajo komunikonte. Në këto kushte, ai kishte marrë përsipër të kujdesej për të ëmën, të justifikonte por edhe të mbulonte sjellje të caktuara të së ëmës. E shikonim shpesh t'i afrohej me ndrojtje, t'i fshinte lotët, ta përkëdhelte dhe t'i thoshte” e bukura”. Nuk mungonin rastet kur ai edhe gënjente për të justifikuar largimet e gjatë të nënës nga strëhëza. “mami ka shkuar tek doktori”- ishte shprehje që i ishte urdhëruar të thoshte. Çuditërisht nuk bënte asnjë lloj komenti tjetër. i pyetur për babain, përsëriste gjithnjë të njëjtat deklaratë që kishte bërë edhe nëna e tij. “Ai të vret”, “ai ka revolë”, “ai deshte t’ja çante mamit barkun me thikë” ishin disa nga shprehjet që ai përsëriste për të atin. Nuk kërkonte kurrë ta takonte. Tek sjelljet e tij ndjehej mungesa e modelit mashkullor. Ai sillte si vajzat. Përdorte mjetet e tualetit të nënës së tij. Krihej si e ëma. E imitonte në sjellje.

Në kushtet e mungesës së vëmëndjes dhe afeksionit nga ana e nënës së tij, ai kërkonte të gjentë ngrohtësi dhe mbështetje tek çdo punonjëse. Mënyra që ai përdorte për të tërhequr vëmëndjen e tyre ishte nëpërmjet vjershave që recitonte. Natyrisht ato reflektonin nivelin e ulët të kulturës së nënës së tij, por ai i përdorte me mjeshtërinë e një fëmije që për të mbijetuar bën çdo përpjekje. Vjersha “o moj pula pikaloshë, që shëtit qoshe më qoshe, as më bën një kokërr ve, ta haj X për mëngjes.” ishte dhurata që ai i ofronte çdo punonjëse në shkëmbim të pak dashurie. Kur tek e ëma u vunë re disa sjellje jo normale dhe lidhje të dyshimta, asaj ju kujtuan rregullat e Strehëzës. Reflektimi i G. ishte i menjëhershëm. Të nesërmen ai ishte i ngrysur dhe aspak miqësor me stafin. Ai ishte prekur prej se ëmes.

G. qante gjithmonë me vete. Kurrë nuk kundërshtoi. Bënte të pamundurën për të kënaqur fëmijët e tjerë të Strehëzës. Por ai kishte një natyrë të ndrydhur, ishte i ngarkuar emocionalisht, ishte tinzar, gënjente, dhe dukej se ishte rritur pare kohe.

Rasti B

Vjen në Strehëz më nënën e tij pas një eksperince dhune ekstreme që ushtrohej ndaj saj edhe në sy të djalit. B. ishte vetëm 3 vjeç. Shumë i dobët fizikisht, i papërqëndruar, shumë i lëvizur, në kufinj të hiperaktivitetit, agresiv dhe i paparashikueshëm në sjelljet dhe shpërthimet e tij. Nuk i pëlqente të shoqërohej apo të luante me fëmijët e tjerë apo me të rriturit. Vazhdimisht klithte. Klithma ishte mënyra e tij e komunikimit kur kërkonte diçka apo kur i kërkohet diçka. Klithmat e

nervozuara dukej se ishin imitime të mënyrës së komunikimit të babait të tij. Të folurit nuk ishte i zhvilluar normalisht, mbase edhe për arësyen e mësipërme por edhe për faktin se ai jetonte në të njëjtën banesë me gjyshërit dhe xhaxhain dhe se ata të gjithë kishin probleme të komunikimit. Sipas fjalëve të nënës së B. në familjen e tyre vetëm bërtitej, njerëzit rriheshin, përplaseshin objektet e shtëpisë, thyheshin karrige dhe familjarët ishin gjithmonë të tensionuar.

Ai gjuante me shqelma fëmijët dhe punonjëset dhe po të të gjente pa mendje mund edhe të të qëllonte apo të të kafshonte.

Ai ishte shumë i lidhur vetëm me nënën e tij. Por edhe kjo lidhje e realizuar në kushtet e mbingarkesës emocionale, nuk ishte normale. Flinte me të ëmën në të njëjtin shtrat dhe sjellja trupore nuk ruante distancat personale. Kjo lloj sjellje u bë objekt i vëzhgimeve dhe vlerësimeve të stafit, deri sa u arrit të zbulohet se djali kishte qënë prezent kur babai e abuzonte seksualisht të ëmën, kur pasi e rrihte e zhvishte dhe e linte të zhveshur me orë të tëra. Në një nga ditët e qëndrimit në Strehëz djali 3 vjeçar iu afrua njëherë nga punonjëset të Strehëzës duke imituar një marrëdhënie intime. Pas bisedave me të ëmën u zbulua se fëmija edhe mund të kishte qënë viktimë e dhunës seksuale të ushtruar ndaj tij nga i ati.

Si konkluzion, mund të themi se B. ishte një fëmijë tipik i dhunuar. Tek ai takoheshin të gjitha karakteristikat e një fëmije seksualisht, fizikisht dhe emocionalisht të dhunuar.

Rasti C

M. ishte një vajzë 12 vjeçe. Ajo kishte ardhur në Strehëz së bashku me nënën e saj nga një rreth jugor i Shqipërisë. Kishte zhvillim normal fizik dhe mendor. Ishte e heshtur, pak e mbyllur në vetvete, me shumë sedër, korrekte, nxënëse me nivel mesatar, ndonëse ishte vajzë inteligjente, por jo shumë e përqëndruar dhe pa shumë vullnet.

Nëna e saj ishte martuar para shumë vitesh me një burrë nga fshati shumë më të ri moshë nga ajo vetë, i papunë, i dhënë pas pijes dhe parazit nga natyra. Pasi është vendosur në qytet dhe është bërë bashkëpronar i shtëpisë ai fillon të ushtrojë dhunë ekstreme ndaj të shoqes. Dhuna ishte e të gjitha formave dhe çdo gjë bëhej në sy të vajzës që tashmë ishte rritur dhe kishte filluar të kuptonte. E shkatërruar personalisht nga dhuna, por edhe e terrorizuar nga ideja se bashkëshorti mund të abuzonte edhe me vajzën që tashmë kishte hyrë në moshën e

adoleshencës, ajo kërkon divorcin, divorcohet, humbet gjithshka nga pasuria e familjes, ndonëse ajo kishte qënë trashgimtare e shtëpisë nga prindërit e saj, dhe për një farë kohe jeton nën të njëjtën çati me ish bashkëshortin esaj. Kjo e acaron edhe më shumë situatën dhe gruaja detyrohet të largohet nga qyteti i saj sepse ndjehet e persekutuar dhe e kërcënuar në çdo moment prej tij.

Fillimisht M. iu gëzua ardhjes në Tiranë, por shumë shpejt filloi të ndjejë mall për babain. U mbyll edhe më shumë në vetvete dhe filloj ta kalonte kohën me vizatime dhe punë më plastelinës. Herë pas here ajo futej në dhomë bashkë me ndonjë fëmijë tjetër, mbyllte derën dhe i zhvishte ata. Nënata e tjera u alarmuan nga sjelljet e saj. Ajo shprehej se luanin shtëpirash.

Për babain nuk parapëlqente të fliste, por edhe kur fliste nuk shprehej negativisht për të. Ajo e vuante mungesën e tij. I mungonin përkëdhelitë e tij megjithë rezervat që kishte e ëma për ato.

M. kishte adaptuar një sjellje negative në këtë situatë duke u përpjekur të përfitonte sa më shumë nga të dy prindërit. Ajo i bënte presion të ëmës se do ta linte dhe do të shkonte tek i ati nëse ajo nuk i blinte ato që ajo kërkonte. Nga ana tjetër ajo i bënte presion të atit se nëse ai donte informacion për ish gruan se me kë takohej, ku shkonte, ku punonte, ai duhej t'i blinte M. gjërat që ajo kërkonte. M. kishte filluar të përjetonte keqformim të personalitetit pa e formuar atë ende mirë.

Rasti D

Am. është një djalë 10 vjeç. Ai shkon në klasë të katërt. Është fëmijë i dobët fizikisht. Nuk ha mirë dhe rregullisht. Është fëmijë tepër i lëvizshëm, jo shumë i përqëndruar, i pëlqen të lozë me fëmijët e tjerë, por i ngacmon ata, i qëllon, i shan duke përdorur një fjalor të pistë, është tinzar.

Ai erdhi në Strehëz bashkë me të ëmën që dhunohej ekstremisht nga bashkëshorti. Jetesa e saj ishte bërë e pamundur në shtëpi. Ajo nuk shikonte asnjë mënyrë që të mund ta detyronte të shoqin të ndryshonte sjelljen e tij. Përkundrajt acarimit dhe përkeqësimit të marrëdhënieve të çiftit, djali vazhdonte të ishte shumë i lidhur me të jatën dhe ta adhuronte atë. E ëma tregonte se kohët e fundit edhe vetë djali ishte bërë viktimë e dhunës që ushtronte i ati. I pyetur për sjelljen e të jatit ndaj tij ai shprehet: “Po, babi më rreh. Bile një ditë më rrahu fare keq. Më tha të shkoja t'i blija një paketë dhe unë zbrita shkallët me vrap, por kur po kthehesha tek shkallët takova një shokun tim. Fola pak minuta me të për sportin dhe hyra në shtëpi. Unë

nuk e prita, por mora një shuplakë të fortë, sa koka më shkoj tek muri dhe më doli gjak nga hundët. Më tepër nuk mbaj mend, por më kujtohet se kur hapa sytë isha në krevat dhe mami po qante mbi mua. Më vonë ajo më shpjegoi se më kishte rënë të fikët. Por ky nuk është rasti i vetëm. Babi më rreh për hiç mos gjë. Kështu bën edhe me mamin”. E megjithëse situata ishte siç përshkruhet më sipër, ai arriti që t'i bashkonte të dy prindërit.

Rasti E

B. ishte një djalë 9 vjeç. Ai ishte i zhvilluar mirë fizikisht, i bukur, por vuante nga sëmundja e hemofilisë. Sëmundja e kishte lidhur edhe më shumë me të ëmën. Herë pas here ai ishte i detyruar të merrte plazëm në spital dhe gjithmonë ai shoqërohej nga e ëma. Nëna e tij ishte shumë e ndjeshme ndaj situatës së të birit, jo vetëm për faktin që ai vuante nga një sëmundje e pashërueshme por edhe sepse ajo ishte diagnostikuar si bartëse e problemit shëndetsor. Ajo ishte fajësuar vazhdimisht nga i shoqi për problemin e të birit dhe ndihej përgjegjëse për situatën. Pas disa vitesh martesë, nga e cila kishin dy djem: B dhe një djalë tjetër më të madh, babai që punonte tek tregu i shkëmbimit valutor, dashurohet me një shitëse ambulante. Ai vendos të divorcojë gruan. E nxjerr nga shtëpia dhe i mban djalin e madh. Pas kësaj ai aplikon për llotarinë amerikane, të cilën e fiton dhe largohet me gruan e dytë dhe djalin e madh. B. dhe nëna e tij mbeten në mes të rrugës, pa asnjë mbështetje. Ata strehohen përkohësisht në Strehëz.

Gjatë kësaj kohe B. shfaqte vështirësi në socializim me fëmijët e tjerë. Ai kishte një fjalor tepër të varfër dhe vulgar. i drejtohej edhe të ëmës shpesh me të njëjtën gjuhë që tyë linte të kuptojë se ai imitonte të atin. B. përjetonte një revoltë të brendshme si pasojë e ndarjes nga i vëllai dhe abandonimi që i kishte bërë i ati. Këtë revoltë ai e shprehte në marrëdhënie me nënën, por edhe me fëmijët e tjerë të cilët i trajtonte me shumë egërsi dhe aspak dashamirësi. Ai ndjehej keq edhe pse i ati kishte zgjedhur vëllain e madh për ta marrë në Amerikë. B. shprehej shpesh “babi nuk më deshte mua se unë jam i sëmurë, prandaj mori vëllain...”. Ndonjëherë ai i kanosej të ëmës duke i thënë “ti më sëmurë”.

Niveli i ulët arsimor i nënës gjente shprehje edhe në disa sjellje diferencuese që ajo mbante me fëmijët. Ajo shprehej se djali i madh ishte më i mënçur, më i bukur, më fisnik, kurse B. vinte më i dobët dhe jo aq i bukur sa i vëllai. E gjitha kjo kishte ndikuar në krijimin e një vetvlerësimi të ulët tek B. që gjatë kohës shprehej në forma të ndryshme. B. kishte rezultate të dobta në mësimet

si rezultat i motivimit të ulët, shpërqëndrimin, dhe mungesës së ndihmës nga e ëma.

B. ishte një fëmijë relativisht i izoluar dhe që mbartëte karakteristikat tipike të një fëmije të dhunuar.

Rasti F

Ata janë motër e vëlla. Ngjajnë shumë si në pamjen fizike ashtu edhe në natyrë me njëri tjetrin. Ata janë respektivisht 12 dhe 6 vjeç. Kanë ardhur në jetë nga dy prindër të martuar me dashuri, të cilët që pas lindjes së vajzës kanë patur probleme. Pas divorcit të parë ata kanë vendosur të ribashkohen duke e pagëzuar martesën këtë radhë më lindjen e djalit. Gjërat nuk kanë ndryshuar ndërkohë. Ato vetëm sa janë acaruar më tej. Historia e divorceve, ndarjeve, bashkimeve edhe me forcë kanë vazhduar pa ndërprerje.

Të dy fëmijët jo vetëm kanë qënë prezent në momentet e abuzimit të nënës së tyre në të gjitha format nga babai, por edhe ata vetë nuk i kanë shpëtuar dhunës. M, vajza e familjes, më e madhja në moshë, përveçse është rrahur, sharë nga i ati me një fjalor tepër vulgar, është nxjerrë edhe në mesnatë nga shtëpia bashkë me të vëllain si dënim për mbështetjen që i kanë dhënë nënës së tyre. Tek M. nuk kanë munguar as ngacmimet seksuale nga i ati. Duke e parë vajzën që rritej përditë ai kishte filluar edhe ta ngacmonte. Nëna tregon se ai e prekte në vende intime, e përkëdhelte në mënyrë provokuese dhe duke pretenduar se ishte i pirë shtrihej mbi trupin e së bijës ose i kërkonte asaj ta shtypte në të gjitha pjesët e trupit. E ëma, e terrorizuar i ka bërë kallzim në polici, por ai asnjëherë nuk është ndaluar dhe pasojat e një veprimi të tillë i kanë vuajtur të tre.

M. nuk i pëlqen të flasë për babain. Ajo është e ndrojtur, jo komunikuese, duket se çdo gjë që ndodh rreth saj e tremb. Duket se bën përpjekje maksimale për të fshehur dhimbjen e saj. Nuk ndjehet e sigurtë. Është e pavëmëndshme ose fiksohet për një kohë të gjatë në objekte që normalisht nuk duket se janë të një rëndësie të veçantë. Ajo nuk ka dëshirë për të mësuar dhe bën të gjitha përpjekje për të mos shkuar në shkollë. Ka rezultate shumë të dobta në mësimet. Prej një kohe relativisht të gjatë ajo urinon natën. Këtë ajo e vuan shumë dhe pas kontrollit mjekësor u vërtetua se problemi kishte bazë emocionale.

E pyetur për përjetimet e saj, ajo nuk prononcohet me lehtësi, por thekson se “më merr malli për shtëpinë, por nuk dua të shkoj se nuk e di çfarë na pret...”

I vëllai nga ana tjetër, është natyrë më e lëvizshme dhe më komunikues. Miqësohet lehtë më fëmijët. Edhe tek ai të bie në sy përpjekja për t'i fshehur gjërat. Ai është tinzar. Me punonjëset sillet mirë, por në mungesë të tyre sillet shumë keq me nënë dhe motrën. I shan, i fyen dhe duket se imiton të atin duke dashur të bëjë rolin e liderit të familjes. Madje edhe fjalori që ai përdor me ata është tipik fjalori i një rrugaçi, taman si fjalori i të atit.

Ai i ka përjetuar të gjitha format e dhunës dhe ai urren të atin gjë që ndryshe nga e motra nuk e fsheh. Ai ndryshon krejt natyrën kur flet për të dhe shprehet “kur të rritem do ta vras babin”. Ai është shumë i lidhur më nënën dhe motrën dhe gjithë vëmendjen e ka përqëndruar tek vizatimet.

10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

10.1 Konkluzione

- ⊕ Abuzimi i fëmijëve është një fenomen gjerësisht i përhapur në Shqipëri, për shkak të traditës së dhunës në familjen Shqiptare, mungesës së institucioneve të specializuara për të luftuar abuzimin e fëmijës, legjislacionit të mangët, dhe infrastrukturës së dobët për rehabilitimin e fëmijëve të abuzuar.
- ⊕ Abuzimi i fëmijëve nuk njihet kufi moshe apo ndonjë kufi tjetër të lidhur me nivelin e arsimit, atë social ekonomik, apo statusin e familjes.
- ⊕ Fëmijët që vijnë nga shtresa më problematike janë më të ekspozuar ndaj të gjitha formave të abuzimit.
- ⊕ Përmasat e këtij fenomeni kanë njohur rritje gjatë viteve të fundit, duke shënuar raste të abuzimit ekstrem siç janë vrasjet brenda familjes dhe vetëvrasjet tek fëmijët.
- ⊕ Dhuna ndaj fëmijëve gjenerohet kryesisht nga mentaliteti patriarkal që dominon në familjen shqiptare si dhe nga mënyra e të konceptuarit të dhunës ndaj fëmijëve si mënyrë e disiplinimit të tyre. Abuzimi i fëmijëve ndodh në shumicën e rasteve nga persona brenda familjes apo afër saj.
- ⊕ Ndërgjegjësimi për fenomenin e abuzimit të fëmijës dhe pasojat e abuzimit ndaj personalitetit të fëmijës nuk janë parë si prioritet i Qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse, gjë që sjell si rrjedhojë një përhapje në shkallë të gjërë të tij.
- ⊕ Në Shqipëri mungojnë qendrat e specializuara për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve të abuzuar dhe Qeveria shqiptare dhe institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë asnjë masë për të nxitur krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për trajtimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijëve të abuzuar.
- ⊕ Institucione si: Policia, Shërbimi Social, Shkolla dhe Shëndeti parësor nuk janë të përgatitura për të njohur shenjat e abuzimit dhe krijimit të një sistemi referimi dhe menaxhimi të rastit, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, burimeve financiare, infrastrukturës së përshtatshme dhe dëshirës për t'u përfshirë në situata të vështira.
- ⊕ Legjislacioni ekzistues nuk përkrah, nxit ose detyron punonjësit publikë (mësues, punonjës social etj) raportimin e vazhdueshëm pranë organeve kompetente si policia ose shërbimi social të dyshimeve ose rasteve të abuzimit të fëmijës. Si rrjedhojë është krijuar një rreth vicioz, ku fëmija që tregon për abuzimin, përfundon përsëri nën abuzim, për shkak se ka treguar është dhunuar.
- ⊕ Ndërhyrjet e shoqërisë civile për rritjen e shërbimeve dhe ndërgjegjësimin kundër abuzimit të fëmijës kanë qenë tepër të limituara dhe të kufizuara.. Bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile përsa i përket punës për eliminimin e fenomenit të abuzimit të fëmijës nuk ka qenë në nivelet e pritshme, duke pasqyruar në këtë mënyrë mentalitetin ekzistues se fëmija është një çështje që i përket familjes dhe vetëm asaj.
- ⊕ Situata e konturuar mbi bazën e të dhënave të mësipërme tregon nevojën për trajnim të të gjithë specialistëve si mjekë, mësues, juristë, punonjës socialë, psikologë, gazetarë, policë etj.
- ⊕ Prindërit vetë kanë nevojë të trajnohen dhe të informohen për mënyra më të mira të prindërimit.

10.2 Rekomandime

Duke patur parasysh situatën e përshkruar më sipër për abuzimin e fëmijëve në Shqipëri, si dhe duke u mbështetur në të dhënat, faktet, dhe konkluzionet, mendojmë se është e nevojshme të rekomandojmë disa aktivitete, ndërmarrje dhe ndryshime që tashmë janë bërë të domosdoshme në nivele të ndryshme.

Për Parlamentin shqiptar

- Parlamenti ne bashkepunim me Qeverine, duhet të përgatisë dhe miratojë ligjin kundër përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve.
- Nën-Komisioni Parlamentar për të Miturit, duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, duke organizuar seanca dëgjimore të hapura me përfaqësues të Qeverisë, institucioneve të saj dhe OJF-ve.

Për Qeverinë Shqiptare

- Të hartojë politika mbështetëse për fëmijët e dhunuar, si dhe të bëhet nxitëse e përmirësimit ligjor për ndalimin e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve.
- Të zgjerojë rrjetin e shërbimeve publike dhe të rrisë numrin e stafit në shërbim të fëmijëve të dhunuar.
- Të planifikojë burime financiare të mjaftueshme në mbështetje të shërbimeve të kualifikuara për fëmijët e abuzuar.
- Të punësojë me prioritet punonjës socialë dhe psikologë në institucionet që merren me edukimin, mirëritjen, kujdesin dhe trajtimin e fëmijëve (shkolla, komisariate policie, spitale, qendra komunitare, burgje etj)
- Të organizojë një Fushatë Kombëtare ndërgjegjësimi për prindërit, punonjësit publik dhe fëmijët për ndalimin e përdorimit të dhunës ndaj fëmijës.
- Të mbështese me prioritet OJF-te, programet dhe shërbimet e tyre për rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijëve të abuzuar.
- Të marrë masa në krijimin e nje Linje Telefoni Kombëtare falas për fëmijët.

Për Ministrinë e Arsimit

- Përfshirjen në kurrikulën shkollore të niveleve të ndryshme të problemeve të dhunës ndaj fëmijëve me qëllim sensibilizimin dhe edukimin e fëmijëve për të mos u pajtuar me këto forma të edukimit të tyre;
- Përfshirjen në kurrikulën për përgatitjen e mësuesve të moduleve që parashikojnë trajtimin e fenomenit të dhunës ndaj fëmijëve;
- Ministria e Arsimit nëpërmjet një vendimi të brendshëm duhet të urdhërojë referimin e të gjitha rasteve të vërejtura të abuzimit të fëmijëve nga stafet e saj, pranë institucioneve përkatëse.
- Të hartojë protokolle dhe standarte për identifikimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar, mbrojtjes së jetës së tyre private, dhe t'i referojë ata pranë institucioneve të specializuara;

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- Të marrë masa të menjëhershme për krijimin e një sistemi të referimit, trajtimit dhe menaxhimit të rastit të fëmijëve të abuzuar në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.
- Të përmirësojë sistemin e mbledhjes të të dhënave për rastet e raportuara dhe trajtuara të abuzimit të fëmijëve nga ky institucion.
- Të mundësojë trajnime mbi dhunën ndaj fëmijëve për stafet mjeksore, sidomos në nivel lokal, që punojnë në sistemin e shëndetësisë;
- Të përfshijë në kurrikulën e përgatitjes së specialistëve të rinj module mbi dhunën ndaj fëmijëve;
- Të hartojë protokolle dhe standarte për identifikimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar, mbrojtjes së jetës së tyre private, dhe t'i referojë ata pranë institucioneve të specializuara;
- Të punësojë punonjës socialë dhe / ose psikologë pranë institucioneve të shëndetësisë.

Për Ministrinë e Rendit dhe Policinë e Shtetit

- Të marrë masa të menjëhershme për krijimin e një sistemi të referimit dhe menaxhimit të rastit të fëmijëve të abuzuar në të gjitha nivelet e policisë.
- Të mundësojë specializimin e të paktën një personi në çdo komisarjat policie për trajtimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar;
- Të përmirësojë sistemin e mbledhjes të të dhënave për rastet e raportuara dhe trajtuara të abuzimit të fëmijëve nga ky institucion.
- Të përfshijë në kurrikulën e përgatitjes së punonjesve të rinj të policisë module mbi dhunën ndaj fëmijëve;
- Të hartojë protokolle dhe standarte për ndjekjen e rasteve të fëmijëve të dhunuar, mbrojtjes së jetës së tyre private, dhe t'i referojë ata pranë institucioneve të specializuara;
- Të punësojë punonjës socialë dhe / ose psikologë pranë çdo komisarjati policie.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të bëhet nxitëse e përmirësimit të legjislacionit dhe të kërkojë zbatimin e legjislacionit ekzistues në mbrojtje të të drejtave dhe mirëqënies së fëmijëve, sidomos nga sistemi gjyqësor;
- Të trajnojë gjykatësit rreth problemit të abuzimit të fëmijëve, trajtimit të tyre, si dhe të miratojë procedura standarte për trajtimin e fëmijëve gjatë procesit gjyqësor dhe mbrojtjes të të dhënave personale të tyre;
- Të punësojë punonjës socialë dhe / ose psikologë pranë sistemit gjyqësor;
- Të përshpejtojë procedurat për ngritjen e gjykatës së të miturve;

Për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale

- Të marrë masa për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë e re Kombëtare për Fëmijët;
- Të ndihmojë në krijimin dhe zgjerimin e rrjetit të shërbimeve për trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve të abuzuar dhe familjeve të tyre;

- Të krijojë procedura standarte dhe kode etike për të gjitha institucionet e saj që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët.
- Të njohë, liçensojë dhe mbeshtesë shërbimet e shoqërisë civile për fëmijët e abuzuar;
- Të koordinojë shërbimet duke i orientuar ato drejt një mbulimi sa më të mirë të të gjithë territorit;

Për Median

- Të luajë një rol aktiv për të kapërcyer stereotipet në trajtimin e fëmijëve;
- Të marrë një rol më aktiv për prezantimin e mënyrave më civile dhe të qytetëruara për edukimin dhe rritjen e fëmijëve;
- Të krijojë hapësira për prezantimin e modeleve pozitive të prindërimit;
- Të krijojë më shumë hapësirë për mendimin e specialistit lidhur me edukimin dhe trajtimin e fëmijëve;
- Të krijojë kushte për trajnimin e gazetarëve gjatë viteve të punës por edhe gjatë viteve të shkollimit për t'u informuar për mënyrat e prezantimit të problematikës së dhunës ndaj fëmijëve;
- Të monitorojë më me kujdes emisionet, programet dhe diskutimet për fëmijët duke eliminuar skenat e dhunshme, që gjenerojnë dhunë;

Për OJF-të dhe Agjensite e Zhvillimit

- Të shtojnë përpjekjet e tyre për sensibilizimin e publikut dhe Qeverisë kundër përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe pasojave të saj;
- Të luajnë një rol aktiv në nxitjen për përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për ndalimin e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve.
- Të zgjerojnë rrjetin e tyre të shërbimeve për fëmijët duke synuar shtrirjen në të gjithë territorin e vendit, si dhe të miratojnë Kode Etike e procedura standarte për trajtimin, kujdesin dhe rehabilitimin e fëmijëve të abuzuar, sjelljes së stafit dhe mbrojtjes të të dhënave personale;

- Të nxisë bashkëpunimin e personave të kualifikuar në Fakultetin e Shkencave Sociale për të realizuar studime, monitorime të situatës dhe shërbimeve për fëmijët.
- Agjensite e Zhvillimit duhet të rrisin financimet e tyre për fëmijët, duke asistuar nisma që kanë të bëjnë me fëmijët e abuzuar dhe të neglizhuar, fëmijët nga zonat e marginalizuara, të drejtat e fëmijëve etj.

11. LITERATURA DHE KONTAKTE

11.1 LITERATURA

- Si të mbrojmë fëmijët tanë nga dhuna - Manual Trainimi për profesionistët që punojnë me fëmijët. Përgatitur nga Streheza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara, botuar me 2003.
- Dosje personale të personave të trajtuar në Strehëzën për Gratë e Dhunuara (1998-2004).
- The maltreated child, Vincent J. Fontana, 1973.
- Working with traumatized children, Kathryn Brohl, 1996.
- Child abuse and neglect, Vernon R. Wiehe, 1992.
- Social Work with children and their families, Christopher G. Petr, 1998.
- Understanding child abuse and neglect, Cynthia Crosson – Tower, 1999.

11.2 KONTAKTE

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijeve në Shqipëri – CRCA

Adresa e zyres: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa Fushave të Tenisit, Kati III, Tirana / Albania
Adresa Postare: Kutia Postare 1738, Tirana Albania
Tel / Fax: + 355 4 242264
E-mail: crca@crca.org.al
www.crca.org.al

Zyra Ligjore e Mbrojtjes Falas të Femijeve - CLPO

Adresa e zyres: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa Fushave të Tenisit, Kati III, Tirana / Albania
Adresa Postare: Kutia Postare 1738, Tirana Albania
Tel / Fax: + 355 4 242264
E-mail: crca@crca.org.al
www.crca.org.al

Qendra e Informacionit dhe Kerkimeve për të Drejtat e Femijeve në Shqipëri – IRCCRA

Adresa e zyres: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa Fushave të Tenisit, Kati III, Tirana / Albania
Adresa Postare: Kutia Postare 1738, Tirana Albania
Tel / Fax: + 355 4 242264
E-mail: ircra@crca.org.al
www.crca.org.al/ircra.html

Streheza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara

E-mail: edlira1960@yahoo.com
ela_kulluri@yahoo.com

Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Shqip: <http://www.keshilliministrave.al/shqip/default.asp>

Anglisht:

<http://www.keshilliministrave.al/english/default.asp>

Telefon: +355 4 229980

Fax: + 355 4 234818

E-mail: administrator@km.gov.al

E-mail: kryeministri@km.gov.al (nese deshiron t'i shkruash drejtperdrejt kryeministrit)

Ministria e Drejtësisë

Adresa: Blvd. "Zog I", Tirana / Albania

Tel/Fax: + 355 4 259388

E-mail: Mail@justice.gov.al

Ministria e Rendit Publik

Adresa: Sheshi "Skenderbej", No. 3, Tirana / Albania

E-mail: mrp@mpo.gov.al

Faqe Shqip: <http://www.mpo.gov.al/>

Faqe Anglisht: <http://www.mpo.gov.al/anglisht/mrp-ENGLISH.htm>

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Tel: + 355 4 364 953

E-mail: mrp@mpo.gov.al

<http://www.mpo.gov.al/policia.htm> (Vetem në Shqip)

Zyra e Avokatit të Popullit

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tirana / Albania

Tel: +355 4 22 97 85

Tel: 0 800 1111 (për të burgosurit)

Fax: +355 4 22 60 95

E-Mail: ap@avokatipopullit.gov.al

<http://www.avokatipopullit.gov.al/>

Olof Palmes Internationella Centrum (Olof Palme

International Center)

Sveavägen 68, plan 5

Box 836, 101 36 Stockholm

Tel: 08 - 677 57 70

Fax: 08 - 677 57 71

E-mail: info@palmecenter.se

<http://www.palmecenter.se/>

Raporti Alternativ i Shqipërisë për Konventën për të Drejtat e Femijes

Anglisht: <http://www.crca.org.al/national%20reports.htm>

Raporti i Qeverisë Shqiptare mbi Konventën për të Drejtat e Femijes

<http://www.mfa.gov.al/english/sectoriraportimeve.asp>

Shqip: <http://www.mfa.gov.al/shqip/sectoriraportimit.asp>

PROFILI I STUDIUESVE

Prof. Asoc. Dr. Edlira HAXHIYMERI

Eshtë pedagoge e Punës Sociale që nga viti 1993 dhe punon pranë Departamentit të Punës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Është përgjegjëse e këtij departamenti që nga viti 1999. Gjatë viteve 2003-2004 ajo mbajti gjithashtu postin e Zv/Rektore së Univeristetit të Tiranës. Është e specializuar në disa vende dhe universitete të botës si Itali, Gjermani, Francë, Angli, Çeki dhe ShBA. Gjatë vitit akademik 1997-1998 ka punuar si pedagoge e Punës Sociale në Universitetin e Grand Valley të shtetit të Michiganit, në SHBA. Ka marrë pjesë në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me kumtesa për problemet e grave dhe të fëmijëve në Shqipëri. Ka botuar disa artikuj, referate dhe tekste mësimore për studentët e Punës Sociale. Është drejtuese e disa projekteve në komunitet për fëmijët dhe gratë. Eshtë e licensuar si trajnuese për problemet gjinore dhe ka punuar për trajnimin e specialistëve të fushës në disa rrethe të vendit dhe në Kosovë. Ka kontribuar në disa studime kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e saj. Ka bashkëpunuar dhe është aktivizuar si eksperte lokale për disa organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, UNICEF, PNUD, etj.

MA. Eliona KULLURI

Eshtë pedagoge e Punës Sociale, Departamenti i Punës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës që nga viti 1995. Mbulon disa lëndë speciale të kurrikulës së Punës Sociale. Është specializuar për punë sociale në disa shtete dhe universitete të botës si Itali, Gjermani, Norvegji dhe SHBA. Eshtë bashkëautore në botimin e teksteve mësimore për studentët e shkencave sociale, si dhe disa studimeve në fushën sociale dhe veçanërisht të çështjeve të dhunës në familje dhe trafikimit.

Ka marrë pjesë në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për problemet e fëmijëve, vajzave dhe grave të dhunuara e trafikuar. Ajo ka koordinuar disa projekte në komunitet për grupet e rrezikuara. Aktualisht aktivizohet në programe të formimit të profesionistëve të fushave së shëndetit publik, administratës publike, dhe të sistemit të drejtësisë. Ka kontribuar për ngritjen e kapaciteteve të specialistëve të shërbimeve për gratë e dhunuara e trafikuar, si dhe fëmijëve në disa rrethe të vendit, por edhe në Kosovë.

MA. Altin HAZIZAJ

Eshtë themelues i Qendrës për Mbrojtjen për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 1997, dhe që nga viti 2002 është Bashkë-Drejtor i CRCA, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ai ka gradën “Master në Studime Europiane”, dhe është bashkë-autor i studimeve dhe raporteve të rëndësishme për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, si: “Rrethi Vicioz”, “Fëmijët e Harruar”, “Duke Pritur Gjykimin”, “Mundësitë e Punësimit të të Rinjve në Shqipëri”, “Shqipëria: Raporti Alternativ për të Drejtat e Fëmijëve” dhe “Askush nuk Kujdeset për Ta” etj. Është redaktor i Revistës së CRCA “Për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri”.

Altin Hazizaj, mbaroi Fakultetin Juridik me rezultate të shkeqyera në vitin 1995, dhe i është kushtuar mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe njeriut që në vitin 1993, duke kontribuar për organizata të njohura në Shqipëri dhe jashtë saj si: Komiteti Shqiptar i Heksinit, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë Civile, Save the Children Kosove, ILO Torino, Eorld Vision Kosove, UNICEF Kosove etj.

Nga viti 1993 deri në vitin 1999 Altin Hazizaj ka punuar si gazetar i çështjeve politike dhe sociale për gazetat: “Koha Jonë”, “Gazeta Shqiptare”, “Dita Informacion”, “Populli PO”; Revistën “KLAN”, si dhe Televizionin Kombëtar “KLAN”.

Ai ka prezantuar dhe shkrime të tij janë përfshirë në një sërë botimesh kombëtare dhe ndërkombëtare për çështje si: abuzimi i fëmijëve, administrimi i drejtësisë për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët e rrugës, fëmijët që punojnë, të drejtat e fëmijëve në Shqipëri etj. Ai ka marrë pjesë në Grupet e Punës së Qeverisë shqiptare për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët në Shqipëri, Strategjisë Kombëtare për të Rinjtë në Shqipëri, Raporteve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut etj.

Njoftim per Copyright-in
E gjithë përmbajtja e këtij botimi është copyright © 2004 dhe © 2005
i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri (CRCA)
(CRCA – Tiranë / Shqipëri)

Te gjithë lexuesit janë të lejuar të printojnë, kopjojnë ose shpërndajnë pjesë të këtij botimi, por gjithmone duke bërë të qartë dhe duke i dhënë atributin e kërkuar për Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri - CRCA. Asnjë pjesë ose i gjithë botimi nuk mund të botohet ose shitet pa lejen me shkrim të CRCA.

Opinionet e shprehura në këtë botim jo detyrimisht shprehin ose përfaqësojnë politikën ose opinionet e CRCA ose ato të donatorëve.

Financuar nga: Olof Palme International Center

Botuar nga CRCA, Tiranë